

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7332 E martë 24 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga PËRPARIM KABO

Sa herë që vjen 23 tetori hungarez kujtesa zbrret te viti 1956. Një ritual që tejkalon thjesht aktin e sjelljes në mënd, sepse në gjithëplanësinë e saj ...

Vijon në faqet 20-21

Revolucioni hungarez i 1956-
dhe kriza e refugjatëve...



Opinion

Ditës

Nga JORGJI KOTE

Këtë shkrim po e fillojmë duke iu krefitur një këngë të famshme që dallohet për disa shkaqe dhe arsye origjinale - formën dhe formatin specifik, ...

Vijon në faqet 21

Sinatra dhe doktrina që fundosi komunizmin



Prokuroria përgjigjet: S' do të tërhiqemi

Tahiri pezullohet nga PS, Edi Rama: Arrestimi i tij, si i Fatos Nanos

Kryeministri: Tre prokurorët u sollën si inspektorë mjedisi që erdhën të hanë mish

Nga DARINA TANUSHI

Kryeministri Edi Rama njoftoi dje, pezullimin e posteve të deputetit Saimir Tahiri në Partinë Socialiste dhe në Grupin Parlamentar, ndërsa vlerësoi punën që Tahiri ka bërë prej vitesh që nga koha ...

Në faqen 3

Vajza: Japim shpërblim kush ka informacion

Elbasan, grabitet biznesmeni, "firojnë" kasaforta e 2 makina

Reagon deputeti i PD, Luçiano Boçi: Krimi u trimërua se e mbron qeveria

Banesa e një biznesmeni të njohur në Elbasan ka rënë pre e hajdutëve. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se në orët e para të mëngjesit të

djeshëm, persona ende të paidentifikuar kanë hyrë në shtëpinë e Ylli Sallës në fshatin Mengel dhe kanë marrë kasafortën ...

Në faqen 8

FORMULA PER LLOGARITJET PER TE PUNESUARIT DHE TE VETEPUNESUARIT

PENSIONET, SA PERFITONI SIPAS VITEVE TE PUNES

Kontributet në skemën e sigurimeve shoqërore, shembujt sa del përfitimi financiar. 30 mijë pensionistë duhet të paraqiten në bankë këtë muaj

Në faqen-7



15 VJET "NEWS 24" – Presidenti Irfan Hysenbelliu: Model suksesi, investim për shoqërinë shqiptare

Televizioni më i madh informativ në vend feston përvjetorin mes qindra të ftuarve në Pallatin e Koncerteve



(Në foto) Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, Presidenti Ilir Meta dhe Presidenti i Focus Media Group Irfan Hysenbelliu, gjatë ceremonisë së 15 vjetorit të krijimit të televizionit informativ, "News 24". Fatmir Hysenbelliu duke prerë tortën me logon e "News 24"

Në faqet 12-13

LISTA E RE

ALUIZNI: Emrat, 1200 familjet që kanë gati lejen e legalizimit

Në faqet 16-17

UDHEZIMI

Lotaria Amerikane, ja kriteret që ju kualifikojnë, flasin ekspertët

Në faqen 11

KRYETARI I PD

Basha: Hetimet për krimin zbulojnë eksponentë të tjerë të PS-së

Në faqen 5

AUTORI: PA DASHJE

Sherri në Sarandë, nxënësi 17 vjeç plagoset me thikë nga shoku

Në faqen 9

ÇESHTJA "TAHIRI" REAGIMET

Vetingu, ambasada e SHBA njofton vendet e lira

"Tahiri", Donald Lu takon ambasadorin italian Cutillo

Ambasadori i SHBA-së, në Tiranë Donald Lu u takua dje, me ambasadorin italian Alberto Cutillo. Lu ka shkuar pikërisht në ambasadën italiane për një takim me homologun e tij italian dhe, siç kuptohet, biseda mes tyre është përqendruar në çështjen që ka nisur prej kohësh të hetohet ajo e Habilajve dhe ku është përfshirë emri i ish-ministrit Saimir Tahiri. Nuk dihet se çfarë të dhënash ka marrë ambasadori amerikan, Donald Lu, por qëndrimin pritë të qartësohet



Ambasadori i SHBA-së, në Tiranë Donald Lu

në ditët në vijim. Ndërkohë ambasada amerikane e ka ndjekur në vazhdimësi dhe e ka mbështetura reformën në drejtësi. Edhe dje, një njoftim ka dalë prej kësaj

ambasade në mbështetje të vetingut.

Institucionet e reja të drejtësisë kanë publikuar disa vende të reja pune. Këtë njoftim e ka bërë të ditur edhe vetë ambasada amerikane në Tiranë. Në faqen e ambasadës së SHBA-së në "FB" thuhet se "Institucionet shqiptare të vetingut po punësojnë për pozicionet e kështilltarëve ekonomikë dhe juridikë në çdo institucion".



Krimet e Rënda: Deklaratat politike nuk do të cenojnë hetimet

REAGIMI

Zyra e kryeministrit: Prokuroria të bëjë punën, të mos merret me politikë

Zyra e kryeministrit Edi Rama iu kundërpërgjigj Prokurorisë për Krimet e Rënda duke i kujtuar që të mos merret me politikanët, por të bëjë detyrën. Zyra e kryeministrit shprehet: "Kryeministri i Shqipërisë, mbron pikëpamjen se detyra e organit të prokurorisë nuk është as të dëgjohet politikën, as të replikojë me politikanët, as të publikojë në media opinionionet e saj, për çfarë thotë një politikan a një tjetër. Po ashtu organi i akuzës, sipas kryeministrit, as ka detyrën dhe as ia lejon etika e funksionit të vet, të ushqejë debatet politike me komunikata që ngajnë si të shkruara në selitë e partive politike". "Ai shpreh, po ashtu, keqardhjen, që organi i akuzës pretendon se ka konstatuar përpjekje për intimidim në fjalën e mbajtur sot prej tij", thuhet në deklaratë. "Kryeministri i rikujton me këtë rast organit të prokurorisë, se ligjvënësit nuk janë noterë të kërkesave të këtij organi, po kanë detyrimin kushtetues t'i lexojnë ato, të dëgjojnë sqarimet e përfaqësuesve të organit në fjalë dhe, pa diskutim, të gjykojnë mbi to. Prandaj ai, përsëritë apelin që Prokuroria e Krimeve të Rënda të bëjë punën që i ngarkon Kushtetuta e Shqipërisë dhe legjislacioni shqiptar, dhe gjykimet mbi politikën t'ia lërë publikut", thuhet në deklaratë. Duke i kujtuar mbështetjen, Rama i uron këtij organi "Punë të mbarë!".

Prokuroria, kryeministrit: Po na intimidon, nuk do tërhiqemi

"Në Kroaci ish-kryeministri u dënua për një orë dore"

Ina Allkanjari

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka reaguar mëngjesin e djeshëm, pas deklaratave të forta të kryeministrit Edi Rama në mbledhjen e Grupit Parlamentar të PS, ndaj tre prokurorëve për çështjen "Tahiri". Sipas organit të akuzës, marrja e rolit të gjykatësit nga kryeministri bie ndesh me Kushtetutën dhe ligjin. Përmes një deklarate për mediat, Prokuroria për Krimet e Rënda kujton përvojën e Kroacisë dhe Rumanisë ku janë arrestuar dhe dënuar dy ish-kryeministra. Gjithashtu, organi i akuzës thekson se po vijojnë hetimet, si për rastin konkret, ashtu edhe për çështje të tjera të krimit të organizuar dhe grupeve të strukturuar kriminale. "Prokuroria për Krimet e Rënda rithëkon qëndrimin e saj se deklaratat politike nuk e kanë intimiduar dhe nuk mund ta intimidojnë aktivitetin e saj hetimor. Organi i akuzës e ka të qartë se, që në fillimet e këtij hetimi, do të përballë me goditje frontale politike, për shkak se person nën hetim është ish-ministri i Brendshëm dhe aktualisht deputet i parlamentit të Shqipërisë", thuhet në deklaratë. "Por, vijon më tej deklarata, -kjo nuk e pengoi aspak që t'i drejtohej Kuvendit të Shqipërisë me kërkesë për autorizimin për arrestimin e personit nën hetim, pasi, në vlerësimin e prokurorëve të çështjes, ekzistojnë kushtet dhe rrethanat ligjore, për të cilat është e nevojshme të merren ma-



Prokuroria e Krimeve të Rënda

sat që parashikon Kodi i Procedurës Penale për rastet e veprave të rënda, si ato të "Trafikut të narkotikëve", kryer në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, si edhe "Korrupsionit pasiv të zyrtarëve të lartë". "Gjithçka çfarë u deklarua publikisht nga Kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama, paraditen e së hënës (dt. 23.10.2017) shkon në të kundërt të asaj që është deklaruar për dy vite me radhë-Reformën

në Sistemin e Drejtësisë. Në fjalën e tij, kryeministri, në cilësinë e kryetarit të subjektivit politik, që ai drejton, shprehu opinionin dhe vlerësimin mbi provat e paraqitura në mënyrë sekrete nga ana e Prokurorisë për Krimet e Rënda në Këshillin e Mandateve dhe Imuniteteve në parlamentin e Shqipërisë. Pra, në mënyrë publike, Kryeministri mori rolin e gjykatës, një atribut që nuk i takon as me Kushtetutë dhe as me ligj", shprehet prokuroria. "Në

vlerësimin tonë, ky qëndrim publik i Kryeministrit është sinjal i qartë që lufta kundër korrupsionit është në nivele të larta, qëllimi i të cilës ishte edhe miratimi i Reformës në Drejtësi", theksohet në deklaratë. "Prokuroria për Krimet e Rënda ka pasur kënaqësinë, disa kohë më parë, të dëgjojë përvojën e homologëve të saj në Kroaci, hetimet e të cilëve, të nisura për një orë dore, përfunduan me arrestimin e më tej, me dënimin e ish-kryeministrit

të atij vendi", përmendet në deklaratë. Gjithashtu, përvoja të ngjashme të suksesshme ka pasur edhe në vende, si Rumania e të tjerë. Prokuroria për Krimet e Rënda është e bindur se i gjithë faktori politik shqiptar, i mbështetur edhe nga partnerët më të rëndësishëm ndërkombëtarë, hartuan Reformën në Drejtësi, duke pasur si guidë të suksesshme përvojën kroate e rumune, të cilat i ndihmuar për t'u integruar në Bashkimin Europian. Nëse hetimet e Prokurorisë do të shoqërohen me ndërhyrje flagrante të politikës, atëherë qëllimi i Reformës në Drejtësi për luftën kundër korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë në nivele të larta, do të jetë një sfidë, e cila nuk do të përballohet me sukses. Gjithësesi, Prokuroria për Krimet e Rënda po vijon hetimet e saj, si për rastin konkret, ashtu edhe për çështje të tjera të krimit të organizuar dhe grupeve të strukturuar kriminale. Deklaratat politike dhe, sidomos presionet indirekte me procesin e vetingut, nuk mund të kenë efekt të kundërt të asnjë procesi hetimor".



Kryeministri njofton pezullimin e deputetit nga postet në PS

Rama: Arrestimi i Tahirit, barbari që ngjan me burgosjen e Nanos

"Tre prokurorët, inspektorë mjedisi që hanë mish"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama njoftoi dje, pezullimin e posteve të deputetit Saimir Tahiri në Partinë Socialiste dhe në Grupin Parlamentar, ndërsa vlerësoi punën që Tahiri ka bërë prej vitesh që nga koha kur erdhi së bashku me të në PS si dhe 4 vitet e drejtimit të Ministrisë së Brendshme. "A është i pafajshëm Saimir Tahiri?", ishte kjo pyetje që Rama e ngriti gjatë gjithë fjalës së tij, në mbledhjen e Grupit Parlamentar të PS-së, por që pret t'i japë përgjigje drejtësisht. "Në Shqipëri, pas prindërve të tij, vjen i pari një njeri që dëshiron të besojë pafajësinë e Saimirit. Jam unë!", tha Rama, duke kujtuar momentin si e afroi Tahirin. "E nisi rrugën e karrierës si koordinator i një rrjeti vullnetarësh, që e ndërtoi vetë nga hiçi. Pastaj u bë ai zëdhënësi i ri i partisë, me një dërrasë të zezë, mbi të cilën shkruante me shkumës para kamerave, faktet komprometuese të korrupsionit qeveritar. Ngjiti shkallët një e nga një, me ambicie të forta e vullnet të veçantë. Për meritat e tij në punë u zgjodh edhe ministër i Brendshëm", tha Rama. Ai shtoi se nuk i ndërhyri asnjëherë në punën si ministër i Brendshëm, duke zbuluar se në 4 vjet nuk i ka rënë telefonave të asnjë drejtori policie. Duke la njohur si meritë Saimir Tahirit, Rama tha se "Për herë të parë në historinë e tranzicionit, Policia e Shtetit nuk ishte më mish për t'u shqyer në tepsinë e pushtetit. Dhe, edhe aleateve tanë të vegjël, - po me oreks të madh, si çdo i vogël që do të rritet me nxitim, - iu ndalua futja e duarve, të kudondodhura të partive, nën mëngën e Policisë së Shtetit". Ai pohoi se Tahiri ka patur besimin e jashtëzakonshëm të tij dhe me pas edhe të grupit parlamentar, pavarësisht qejfmetjeve si fillim. Duke ngritur sërish pyetjen se a është i pafajshëm Saimir Tahiri, Rama tha: "Ky është një rast atipik, ku unë gjendem në një pozitë atipike, pikërisht për shkak se Saimir Tahiri, kjo dihet botërisht, nuk ishte njëri nga ministrat e qeverisë sime deri dje. Jo, ai ishte ministri më i ekspozuar i saj, më popullor i opinionit dhe shumicës dhe më i urreyer në sytë e pakicës - shpesh



Kryeministri Edi Rama dje në mbledhjen e Grupit Parlamentar

Seanca

Çështja "Tahiri" do të jetë pikë e parë e rendit të ditës në seancën e së mërkurës. Në urdhrin e firmosur nga Gramoz Ruçi për Shërbimin e Seancave Plenare, është kërkuar që të merrin masat e menjëhershme për njoftimin e të gjithë deputetëve për rendin e ditës. Gjithashtu, në seancë pritet të miratohet edhe programi dhe kalendari i punimeve të Kuvendit.

këto shkojnë bashkë, sidomos në Shqipëri, - me sukseset më të duartrokitura publikisht dhe akuzat më të panumërta publike - këto shkojnë gjithmonë bashkë në Shqipëri, ku suksesi është edhe një lloj i veçantë mallkimi, - e mbi të gjitha, ministri i Brendshëm perceptohej nga të gjithë, jo pa arsye, edhe pse, sipas meje, pa të drejtë, si bashkëpunëtorim im më i ngushtë dhe si i preferuari im në kabinet". Në një fjalim të gjatë, Rama tha dje, përpara deputetëve të PS-së se nuk

është pishman që e mbështeti Saimir Tahirin si ministër në 4 vite. Më tej ai tha: "Drejtësi, po. Deri në fund dhe ta mësojnë të gjithë njësoj. Arbitraritet, jo. Ndaj kurrkujt dhe ta harrojë kush e con sot nëpër mend". Duke kritikuar qëndrimin e prokurorisë që i kërkoi sipas tij të akuzuarit të paraqesë prova, Rama u shpreh: se tre prokurorët e ulën institucionin e tyre në pikën e më të ulët historike. "Por, nëse edhe mund të provoj ta besoj, që ata mund të jenë të bindur se Saimir Ta-

hiri është një kriminel ndërkombehtar me damkë, nuk e gjej dot, sinqerisht, asnjë lloj mundësie të besoj se ata njerëz, sidogoftë me shkollë e me njëfarë eksperience, e besonin vërtetë se ato katër fletë bakalli dhe ato këndra faqe të nxjerra në mexhelis nga tellalli, justifikojnë faturën e arrestit me burg të një deputeti! Kurrë nuk e besoj dot!", tha Rama. "Ata kishin ardhur si ata inspektorët klasikë të mjedisit, për të ngrënë mish, pas vënies së gjobës arbitrare në një klub fshati, dhe u kthyen në studio avokatore e prokurorisë", - krahasoi Rama. Kryeministri tha se kjo "barbari" ngjan edhe me historin e burgosjes së ish-kryetarit të PS-së, Fatos Nano. "I vetmi politikan i dënuar me burg në këtë vend, në 27 vjet, me të njëjtën lehtësi vrrastare, bazuar natyrisht, kjo është një coincidençë ironike e fatit, në ca letra magazinash nga Italia, pa asnjë lidhje direkte me të, po në emër të medemek luftës të së resë, për të bërë drejtësi kundër korrupsionit të së vjetrës". Saimiri Tahiri do të jetë një njeri i lirë dhe deputet i lirë, për të bërë betejën e tij të lirë jashtë forumit të partisë dhe jashtë Grupit Parlamentar të PS-së", deklaroi Rama duke thënë se pas këtij procesi nëse del i pafajshëm mund të rikthehet në PS në vendin që i takon.

MUNGESA

Deputeti Saimir Tahiri mungoi në mbledhjen e djeshme të Grupit Parlamentar të PS-së, ku kryeministri deklaroi pezullimin e funksioneve të tij. Duket se vetë deputeti e ka marrë këtë vendim përpara se sa kjo të deklarohet nga kryeministri, duke dashur t'i heqë kështu një barrë kolegëve të tij.



Presidenti pret kryekomunaret e Ulqinit e Preshevës

Meta: Unifikim i faktorit politik shqiptar në Mal të Zi

Unifikimi i qëndrimeve të faktorit politik shqiptar në Mal të Zi, do ta bënte më të lehtë realizimin e të drejtave të shqiptarëve, ashtu siç janë në Kushtetutën e Malit të Zi", deklaroi dje, Presidenti i Republikës, Ilir Meta, gjatë një takimi me Kryetarin e Partisë "Forca Demokratike", njëkohësisht kryetar i Komunës së Ulqinit, Nazif Cungu. Presidenti Meta vlerësoi kontributin e dhënë nga shqiptarët e Malit të Zi, në forcimin e marrëdhënieve shumë të mira mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, si dhe për pavarësinë, anëtarësimin në NATO dhe integrimet evropiane të Malit të Zi. Presidenti theksoi rëndësinë e përmirësimit dhe shtimit e pikave të kalimeve kufitare mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, sidomos zgjerimin e kalimit kufitar Sukobinë - Muriqan, si dhe mundësinë për kalimin e mallrave në këtë pikë të kalimit kufitar, duke pasur parasysh që ajo është e projektuar për kalimin e 400 mijë personave dhe tani ka tejkalluar mbi 2 milionë persona në vit. Po dje, Presidenti takoi edhe kryetarin e partisë "Alternativa për Ndryshim", njëkohësisht kryetar i emëruar i Komunës së Preshevës, Shqipërim Arifi. Meta theksoi rëndësinë që ka bashkëpunimi mes faktorit politik shqiptar në Preshevë dhe në të gjithë Luginën, për realizimin e nevojave dhe interesave politike, ekonomike dhe të gjitha fushave të jetës për shqiptarët e Luginës.



KUFIRI

Presidenti theksoi rëndësinë e përmirësimit dhe shtimit e pikave të kalimeve kufitare mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, sidomos zgjerimin e kalimit kufitar Sukobinë - Muriqan

Zbardhet procesverbali i Konferencës së Kryetarëve

PS-PD nisin negociatat për amendime në Rregulloren e Kuvendit

PS dhe PD kanë nisur punën për draftimin e amendimeve për Rregulloren aktuale të Kuvendit. Nga procesverbali i Konferencës së Kryetarëve të datës 4 tetor zbulohet se kryetari i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla, ka qenë ai që ka zbuluar edhe negociatat që po zhvillohen në këtë kohë me palëve. "Gjeja tjetër për të cilën dua të njoftoj Konferencën e Kryetarëve, diskutimet me kolegët e grupeve të tjera parlamentare na kanë çuar në nevojën për të bërë një projekt të ri, disa ndryshime për sa i përket axhendës së funksionimit



parlamentar, ende nuk është i detajuar si dokument, është ende në formën e një drafti, që duhet të marrë, sigurisht, konsensusin e tri grupeve parlamentare, pra duhet të vijë si material i përbashkët i tri grupeve parlamentare", është shprehur Balla. "Për të paraprirë dhe për të respektuar tërësisht

Rregulloren e Kuvendit, besoj se kam edhe konsensusin e zotit Spaho, që, le të themi, të hapim shtegun ligjor përmes Rregullosës që të bëjmë disa ndryshime", deklaroi Balla. Ndërsa nënkryetari i parlamentit, Edmond Spaho, konfirmon bisedimet që po zhvillohen për amendamentet e reja, ndërsa tregohet i kujdesshëm që në kuadër edhe të bashkëpunimit të opozitar me LSI, të respektohet edhe kjo forcë politike. "Ne nuk kemi rënë ende dakord, kemi diferenca për çështje të veçanta dhe do të duhet që të rakordojmë për këto para se materiali të kalojë në seancë plenare.

ÇESHTJA "TAHIRI" AKUZAT

Ish-kryeministri zbardh sms-në e "qytetarit dixhital": Ministri tjetër i filmuar

Valentina Madani

Ish-kryeministri, Sali Berisha denoncoi dje ministrin Damian Gjoknuri, i cili, sipas tij, është filmuar duke dhënë para te Habilajt për të blerë votat në fushatë. Denoncimin e tij Berisha e bazon te "qytetari dixhital". Ish-kryeministri Sali Berisha tekso publikoi emrin e ministrit tjetër që është filmuar me Habilajt shprehur se është ministri Gjoknuri, i cili është parë në fushatë duke i dhënë para Habilajt për të blerë votat. "Gjoknuri në teps! I filmuar duke i dhënë para Habilajt në fushatë për të blerë votat! Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital! Sb". - shkruan në "Facebook" Berisha, ku publikoi edhe mesazhin nga qytetari dixhital. "Përsëritje Doktor! Gjatë fushatës elektorale të fundit, Habilajt uleshin për dreka dhe darka me Damian Gjoknurin në Vlorë. Madje Habilajt kanë edhe regjistrime duke i ofruar para në dorë D.Gjoknurit. Kanë pasur marrëdhënie të rregullt interesash Gjoknurin. Ju uroj shëndet. Anonim, Ju lutem!" - shkruan ai. Por i menjëhershëm ishte reagimi i ministrit Damian Gjoknuri, i cili tekso i referohet ish-kryeministrit, si pinokio dixhital, mohon totalisht njohjen me Habilajt. "A mund ta besojë njeri pinokun dixhital, atë që nuk njihet as baxhanakun e tij dhe nuk e dinte as ku i binte Gërdecit? Habilajt nuk i njoh e as nuk kam pasur kurrë marrëdhënie me ta. Pati i keq i shpifësit dixhital, që po detyrohet të sajohet e kërkohet lidhje imagjinare mes morisë së fotografive në takimet elektorale me mijëra qytetarë të Qarkut të Vlorës", deklaroi ministri Gjoknuri. Moisi Habilaj një nga vëllezërit Habilaj u arrestua në Itali si koka e bandës së trafikut të drogës. Dy vëllezërit e tjerë, Artan dhe Florjan Habilaj janë në kërkim. Për çështjen Habilaj u akuzua nga prokuroria edhe ish-ministri, Saimir Tahiri. Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje edhe mesazhet e dy qytetarëve dixhitalë, të cilët i ankohen se nipat e Arben Ndokës janë autorë të plagosjes së ndodhur pasditën e 22 tetorit 2017 në Shëngjin. Pas ngjarjes, policia nuk dha emrat e autorëve të plagosjes së Samet Berçaj, 19 vjeç dhe Florian Dushku, 28 vjeç. "Në Shëngjin, në qendër të qytetit, nga një automjet, persona akoma të pidentifikuar, kanë plagosur me armë zjarri shtetasit S.B. 19 vjeç dhe F.D.

Berisha: Gjoknuri mori para nga Habilajt. Ministri: Shpifës dixhital! Përplasja për blerjen e votave nga krimi



DENONCIMI

Ish-kryeministri Sali Berisha, tekso publikoi emrin e ministrit tjetër që është filmuar me Habilajt, shprehur se është ministri Gjoknuri, i cili është parë në fushatë duke i dhënë para Habilajt për të blerë votat.



Gjatë një seance parlamentare

"Qeveria lejoi kultivimin e kanabisit"

Agron Duka: Votat u blenë me paratë e krimit

Kreu i PAA-së Agron Duka akuzoi dje se "Zgjedhjet u blenë me paratë e kanabisit dhe kjo është bërë në bashkëpunim me qeverinë". Sipas tij nuk ka rëndësi nëse përgjegjës është Tahiri apo Rama, por faktet janë kokëfortë se qeveria lejoi kultivimin e kanabisit. "Është e pamundur të mund të ketë një rezultat real me përzjerjen e njerëzve të fortë, kriminelëve, administratës dhe blerjen e votave që u bë në mënyrë masive në zgjedhjet parlamentare. Një gjë është e evidente që nga partnerët tanë u vërtetua që zgjedhjet janë blerë me paratë e kanabisit dhe se kjo është bërë në bashkëpunim me qeverinë. Se ishte Saimir Tahiri, apo ishte Edi Rama, kjo nuk na intereson, e rëndësishme është që qeveria lejoi kultivimin e kanabisit. Kanabisi derivoi paratë e krimit dhe nga paratë e krimit u blenë zgjedhjet", - tha z.Duka. Deklaratë Duka i bëri gjatë takimit të Asamblesë Kombëtare të PAA që u mbajt gjatë fundjavës ku u vendos që në zgjedhjet e ardhshme vendore Partia Agrare Ambientaliste do të garojë nën siglën e saj politike për anëtarët e këshillave bashkiakë.

28 vjeç, banues në Shëngjin, të cilët po lëviznin me këmbë në trotuar"-informoi policia", thuhet në mesazhin drejtuar z.Berisha. "Lezha në terrorist! Banda e Arben Ndokës

së PS, përgjaj Lezhën. Nipat e tij në kërkim derdhin breshëri kallashnikovi mbi dy të rinj. Çunat e krimit i ndihmojnë!", - shkruan ish-kryeministri Berisha.

Rama kujtoi Gërdecin, Berisha: Bashkëpunëtor në krim

Djali i ish-kryeministrit të vendit, Shkëlzen Berisha reagoi dje kundër deklaratave të kryeministrit Rama lidhur me çështjen Tahiri dhe largimin e tij nga Grupi i PS deri në përfundim të hetimeve. Berisha shprehur se, kryeministri nuk e mburon deputetin Tahiri si prind, por si një trafikant në bashkëpunim. "Rama nuk e mburon Tahirin si prind, por si bashkëpunëtor në trafik. Ligjit nuk i duhet përjashtimi i Tahirit, por imuniteti që e mburon nga drejtësia", - shkruan Shkëlzen Berisha. Reagimi erdhi pas deklaratave të z.Rama dje në Grupin PS: Kujt dhe për llogari të kujt deshën t'ia shesin këtë faturë arresti me burg të një deputeti? Këta prokurorë, të cilëve ky popull u ka besuar drejtësinë për krimet më të rënda, ndëshkimin për vrasësit, trafikantët, të korruptuarit e këtij vendi. O Zot! Kështu i luftojnë kriminelët këta?! Me etj.? Apo na dinë ekspertë kontrabël nga ata që firmosin bilance false për të marrë rryshfet ose mos na dinë gjë për inspektorë pune nga ata të cilëve fëmijët e skllavëruar që çmontonin municione në fabrikën e vdekjes në Gërdec u dukeshin si kafshë hamallëku?!



Noka-Ramës: Kryeministër, të ka shtrënguar keq Saje qorri

Deputeti i PD-së, Flamur Noka reagoi dje pas deklaratës së kryeministrit Rama për akuzat ndaj Saimir Tahirit, ku akuzoi prokurorinë se nuk ka prova për arrestimin e deputetit Tahiri dhe se Grupi Parlamentar i PS, do votojë unanimisht kundër kërkesës për arrestimin e tij. Sipas tij, shtrëngata të forta do vijjnë të cilat do shkulin kryeministrin Rama dhe organizatat e tij kriminale. "Po me dhimbshesh z.Kryeministër: Të paska shtrënguar shumë keq Saje qorri...Ato ecejaket e misionarëve nga shtëpia e tij në tänden e paskan bërë efektin... Po të shoh sot të rrudhur e të mbledhur sa një grusht...Po të shoh sot se po kërcën pupthi pa pushim tekso flet...Hapja e kutisë së Pandorës se krimi të Saje qorrit ju ka bërë të gjithëve të ktheheni në avokat të zellshëm të tij, bilës edhe me tej, në ushtar të tij. Kërcën prifti nga belaja-thotë populli. Druri i shtrembër jo vetëm që u drejtua, por na u bë rrap madhështor i patrazuar nga shtrëngatat....Por ke harruar se është vaditur 4 vjet nga krimi e droga ky rrap! Jot se bashku me ty...Dhe këtë gjë sot e dinë gjithë shqiptarët, por ca teferet të rëndësishëm i kanë dhe ndërkomitetarët. Shtrëngat që po afrojnë do të të shkulin ty dhe organizatën tënde kriminale që quhet qeveri...Prisni, prisni, s'keni parë asgjë akoma...", - shkruan Noka.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankimin për shpëtim e pasurisë së paluajshme "ka pjesë ideale lakuese e delimitit Hyson Mëchmeti Koso, tek pasuria së paluajshme e ligji apartamenti, me numer pasurie 489-1-3, Volumi 11, Faqe 23 në Zonën Kadastrale Nr.8130, me sipërfaqe prej 78.94 m², e ndodhur në Tiranë, Adresa: Ri.Cemal Stafa, Shkalla 1, Kati 2, Ap.3", për shpëtimin e detyrimit në favor të kreditorit Retik Cepeli, për shumën 10400 Usd dhe 139742 lile. Çmimi fillestar me të cilin filon ankimi është në shumën 1480125 (një milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e njëzetë e pesë) lile, e paracaktuar në raport vlerësimit e bërë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr.5812 datë 27.06.2017. Ankimi zhvillohet në datë 02.11.2017, ora 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga Abdi Toptani, Oendra Torre Drin, K1.2, Nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.068922471, 0684054605, email : ermirgodaj@zyrapermbarimit.com



Deputetët pa imunitet, PD diskuton mundësinë e ndryshimit të Kushtetutës

Krimi, Basha: Hetimet do të zbulojnë eksponentë të tjerë të PS

"BE-SHBA të ndalojnë presionin e Ramës ndaj drejtësisë"

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se po bën gjithçka për të penguar hetimin e çështjes "Tahiri", duke minuar reformën në drejtësi dhe vetëgjyqësinë dhe duke kërcënuar prokurorinë. Në një situatë të tillë, Basha u bëri thirrje Komisionit të Bashkimit Europian dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe partnerëve të tjerë perëndimorë që kontribuan për hartimin dhe miratimin e reformës në drejtësi, të bëjnë presion ndaj kryeministrit dhe mazhorancës që të ndërpresin menjëherë këtë fushatë kërcënimesh dhe presioni ndaj drejtësisë. Sipas Bashës, ky sulm ka për qëllim gjunjëzimin e drejtësisë dhe garantimin e pandëshkueshmërisë së politikanëve të ekspozuar publikisht si të lidhur me krimin. Për kreun e PD-së, nëse qeveria do të lejojë të shantazhojë, kërcënojë dhe frikësojë drejtësinë, korrupsionin dhe krimin në Shqipëri do të rritet më tej. "Nëse politikanë nën hetim për lidhje me trafikun e drogës si Saimir Tahiri lejojnë të kërcënojnë dhe shantazhojnë drejtësinë, në Shqipëri do të thellohet sundimi i kriminit dhe korrupsionit", nënvizon Basha. Kreu i PD-së kërkoi që ish-ministri Tahiri t'i nënshtrohet ligjit si çdo qytetar tjetër dhe nuk duhet të mbrohet nga imuniteti parlamentar dhe nga mbrojtja politike e shumicës në pushtet. Z.Basha akuzoi më tej se Edi Rama rrëzoi kërkesën e Antimafias italiane, pasi ai është i marrë peng nga Saimir Tahiri. "Edi Rama ka shkelur Kushtetutën dhe ligjin për të mbrojtur Saimir Tahirin. As nuk ka të drejtë të kthehet në gjykatë. Rama po e mbron, sepse është peng i Tahirit dhe ka frikë nga hetimi i pavarur i drejtësisë, që do të zbulojë edhe eksponentë të tjerë të qeverisë", tha Lulzim Basha. Sipas tij, vendi është në krizë totale kushtetuese, politike dhe morale dhe Edi Rama ka marrë fund si kryeministër. Nga ana tjetër, demokratët po diskutojnë mundësinë e propozimit të një amendamenti kushtetues për heqjen e imunitetit për deputetët. Ende nuk ka një vendim zyrtar, por mësohet se diskutimi është zhvilluar në



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

Takimi

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi takoi dje kreun demokrat Lulzim Basha në selinë e PD. Takimi vjen ndërkohë që opozita ka intensifikuar aksionin e saj opozitar pas kërkesës së Prokurorisë së Krimeve të Rënda për arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri.

BOJKOTI
Deputetët e PD-së do të bojkotojnë komisionet deri të mërkurën. Shkak i këtij vendimi është bërë qëndrimi i mazhorancës për çështjen e deputetit Tahiri. Demokratët munguan dje në mbledhjen e Komisionit kuvendtor të Ligjeve. Vendimi për bojkot vjen në një kohë që parlamenti pritet të vendosë të mërkurën kundër autorizimit të prokurorisë për arrestimin e ish-ministrit Tahiri.

LSI, Vasili: Kryeministri, njësh me krimin

Për kreun e deputetëve të LSI-së, petrit Vasili, kryeministri Rama e pranoi publikisht që është i dorëzuar, peng dhe shërbëtor i trafikantëve dhe kriminelëve dhe se kryeministri Rama e donte reformën në drejtësi vetëm për të mbrojtur trafikantët dhe kriminelët, të cilët sipas Vasilit, i mbron dhe përdorte vetë kryeministri. "Kryeministri, i dorëzuar totalisht të krimi. Kryeministri, njësh me krimin. Ditë shumë e keqe për vendin. Kryeministri i dorëzuar, peng dhe shërbëtor i trafikantëve dhe kriminelëve sot (dje) e pranoi publikisht përpara të gjithë shqiptarëve këtë. Reforma në drejtësi e këtij të inkriminuarit në krye të qeverisë sot ka rënë. Kryeministri donte reformë në drejtësi që të mbronte trafikantët dhe kriminelët që i mbështeste dhe i përdorte dhe një drejtësi tjetër, që godet pa mëshirë njerëzit e zakonshëm, të pambrojturit dhe të varfrit", shkruan Vasili në një postim në "Facebook".



DEKLARATA

Luan Rama: LSI, votë për arrestimin e Tahirit

Nënkryetari i LSI-së, Luan Rama, deklaroi dje se LSI do të votojë në Kuvend për kërkesën së prokurorisë për arrestimin e deputetit Tahiri, teksa nënvizoi se grupi pret që Kuvendi të respektojë ndarjen e pushteteve. "Grupi parlamentar i LSI rithekson edhe njëherë qëndrimin e vet, parimor, ligjor dhe në përputhje jo thjesht dhe vetëm me moralin tonë politik, por edhe në përputhje me aspiratën e qytetarëve, të cilët presin nga Kuvendi dhe nga të zgjedhurit e popullit në forumin më të lartë të vendimmarrjes, qasje që respekton ndarjen e pushteteve. Ne do të votojmë sipas kemi konfirmuar, pro", deklaroi z.Rama.

Sulmi i Ramës ndaj prokurorisë, Kryemadhi: I paprecedent

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se po shantazhon drejtësinë, duke i dalë në mbrojtje kriminit dhe trafikantëve. Sipas saj, PS-ja e ktheu Këshillin e Mandateve në gjykatë politike. "Shqiptarët prisnin më të paktin veprim që kryeministri i tyre duhet të bënte, të lejonte drejtësinë të zbardhte të vërtetën. Ata panë sot kryeministrin shqiptar që shndërrohej në një mburojë të kriminit. Shqiptarët panë një kryeministër që shantazhon hapur drejtësinë dhe kërcënon atë duke dashur t'i lërë shqiptarët në duart e trafikantëve që po helmon brezin e ri dhe po dëmtojnë shpresën dhe të ardhmen e shqiptarëve. Edi Rama po lë shqiptarët në duart e kriminelëve, gjobëvënësve, të vrasësve me pagesë dhe profesionistë dhe po u hap trafikantëve autostrada të reja të trafikut të drogës, armëve dhe shumë trafikeve të tjera të rrezikshme", deklaroi zj.Kryemadhi. Në një dalje për mediat, Kryemadhi tha se drejtësia po përballet me pengesë të pasqor për të bërë punën e saj, ndërsa Ramës i kujtoi se është në shkelje të Kushtetutës dhe rekomandimeve të Komisionit të Venecias. "Drejtësia po përballet sot me një pengesë të madhe, që nuk janë vetëm kriminelët, por edhe kryesuesi i falangës politike, që mbështet dhe sakrifkohet për ta. Kryetari i Kuvendit dhe mazhoranca e kthyer Këshillin e Mandatit dhe Imuniteteve në një gjykatë politike. Ata dhunuan Kushtetutën, nga garante që ishte, e kthyen në mbështetëse të kriminit", theksoi zj.Kryemadhi.



mbledhjen e grupit parlamentar dhe kjo iniciativë vjen pas refuzimit të mazhorancës për të autorizuar arrestimin e Saimir Tahirit. Pas mbledhjes së grupit, kreu i PD-së theksoi se kryeministri Edi Rama ka shkelur ligjin dhe Kushtetutën për të mbrojtur ish-ministrin Tahiri. "Parlamenti nuk ka të drejtë të rrezojë një kërkesë të organeve të drejtësisë të bërë konform rregullave, as nuk ka të drejtë të kthehet në gjykatë

dhe të gjykojë provat, kjo i takon gjykatës. Edi Rama po mbron Saimir Tahirin, sepse është peng i lidhjeve kriminale të Saimir Tahirit, i trafikëve të drogës dhe sepse ka frikë nga hetimi i pavarur i drejtësisë, hetim që do të zbulojë edhe bashkëpunëtorë të tjerë në kupolën qeveritare, të kriminit të organizuar", theksoi z.Basha. Ai shprehu shqetësimin se drejtësia është e nëpërkëmbur dhe e kërcënuar. "Vetëgjyqësia është e marrë fund me këtë qëndrim të Edi Ramës, që po e përdor për të kërcënuar prokurorët vetëm pse guxojnë të hetojnë Saimir Tahirin dhe vendi është në një krizë totale kushtetuese, politike dhe morale. Mazhoranca moralisht është e vdekur. Edi Rama 'de facto' ka marrë fund si kryeministër", deklaroi ai. Përballë kësaj situatë, Basha tha se opozita është në konsultim të vazhdueshëm me qytetarët dhe faktorët ndërkombëtarë. "Ne si opozitë jemi dhe do të jemi në konsultim të vazhdueshëm me qytetarët dhe me faktorin ndërkombëtar për t'u përgjigjur kësaj gjendjeje, kësaj krize të thellë të vendit", u shpreh z.Basha. I pyetur mbi qëndrimin e ndërkombëtarëve për këtë situatë, Basha u përgjigj: "Unë nuk jam zëdhënës i ndërkombëtarëve, por jam partner i tyre".

Zyra Permbledhje Kozeta Caka njofton shpalljen e ankandit të Iper shpalljen e "Pasurisë së Palajshme të Njëri Aro", me Nr. 101, të ndodhur me ZK 2947, vol 5, fq. 94, me sipërfaqe 400 m², Pezë, Tiranë, në pronësi të dëbtorit Ismail Gjata. Ankandi fillon me çmim fillestar 1.713.256 leke. Ankandi do të zhvillohet në datë 07.11.2017, ditën e martë, ora 15:30 - 16:30, pranë Zyres Permbledhje Private Kozeta Caka në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", Pallati "Palma e Arde", Kati 1, Nr. 22, Tirane. Te interesuarit të kontaktojnë në Tel: +355 44532280.

ÇESHTJA 'HABILAJ'

INTERVISTA NE 2015

VLORE

Pk ditë pas arrestimit të kushëririt të Moisi Habilaj në Itali dhe akuzave se ai dhe vëllezërit e tij janë pjesë e një organizate të trafikut të drogës, "Gazeta Shqiptare" rikthen një pjesë të intervistës së dhënë për gazetarin Enrik Mehmeti, dy vite më parë, nga vëllai i madh i të arrestuarit. Moisi Habilaj, është kushëri i ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Ai u kap një javë më parë në Itali, së bashku me 6 persona të tjerë, mes tyre edhe shqiptarë. 39-vjeçari, prej 4 vitesh mbahej nën përgjim nga autoritetet e vendit fqinj, ndërsa në dosjen mbi 400 faqe përmendet si i implikuar edhe ish-ministri Tahiri.

Artan Habilaj është një prej njerëzve më të akuzuar nga ana e opozitës, si njeriu pranë ministrit, dhe sipas tyre ka lidhje me trafikun e drogës në qytetin e Vlorës. Sipas opozitës ai disponon automjetin e ministrit Tahiri, me të cilin sipas akuzave të fundit janë kryer trafiqe. Në qendër të akuzave ka qenë automjeti tip "Audi", i cili ka qenë në qendër të akuzave edhe nga Zaganit. Cila është përgjigja juaj për këto akuzat?

Në asnjë rast nuk është kapur as me drogë, as në kundërvajtje me ligjin. Është ndaluar si çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë për kontroll, si në të gjitha rastet, e më pas ka vazhduar normalisht. Nuk ka pasur asnjë rëndësi nëse makina është e ministrit apo e kujt do goftë.

Kjo makinë është përfolur se ka dalë shpesh jashtë shtetit, e kryesisht drejt shtetit grek. Këto lëvizje të shpeshta, pse kanë ndëzuar akuzat e opozitës për trafik drogë?

Unë kam dokumentacionin që vërteton se babain e kam çuar në qytetin e Janinës edhe tre herë në muaj për arsye shëndetësore. Dhe për këtë kam fakte. Dhe absolutisht nuk bëhet fjalë për drogë.

Kur e keni marrë makinën e ministrit?

E kam marrë në 2013, në tetor.

Pasi e keni marrë makinën, pse nuk e keni kaluar në emrin tuaj?

Me sa di, z.Saimir Tahiri ka pasur një problem me fëmijët e Berishës, dhe është bllokuar nga përbarimi për të mos kaluar në pronësi të tjetrit.

Po sa i takon akuzave që kjo makinë është përdorur pranë nga z.Tahiri?

Po është e vërtetë, z.Tahiri e ka marrë njëherë këtë makinë për arsye familjare për të dalë jashtë vendit, por nuk e di ku. E ka kërkuar njëherë dhe e ka marrë, por kjo për

Zaganit i thashë: Mos më ndiq më! Ja pse na e kërkoi Tahiri prapë "Audi"

"Nuk jam kapur asnjëherë me drogë, kam biznes fruta-perimesh"

Artan Habilaj: Jam kontrolluar si gjithë të tjerët



Moisi Habilaj



Artan Habilaj

DEKLARATA E ZAGANIT

Ish-kreu i Policisë së Antidrogës në Fier, Dritan Zaganit, i cili tashmë ndodhet për azil politik në Zvicër, në një intervistë për medianë siciliane të Katania "Meridionews" bëri një parashikim lidhur me pëshkrimin "Tahiri". Ai theksoi se parlamenti do të votojë kundër heqjes së imunitetit për deputetin Tahiri. Sipas Zaganit, ky trafik kishte mbrojtje në nivel të lartë, pasi shpesh parat e kriminit financonin fushatat elektorale. "Parlamenti shqiptar do të votojë kundër, pasi Saimir Tahiri është vetëm një hallkë e një zinxhiri të gjatë që nuk mund të priset. Pasi më të mund të rrezohet dhe qeveria shqiptare", pohoi Zaganit.



Dritan Zaganit

arsye se s'ka pasur makinën e tij.

Cila është lidhja fisnore që ju keni me ministrin Tahiri?

E kam kushëri të largët, në shkallën e gjashtë është pak. Gjyshja ime me stërgjyshen e zotërisë në fjalë, kushërinj të largët.

A keni pasur njohje me Zaganin, ndonjë njohje, apo kontakt ju apo ndonjë nga vëllezërit tuaj?

Unë nuk kam pasur absolutisht kontakte me z.Zaganit, thjesht në një moment të caktuar në Durrës më është bllokuar një shumë lekësh, dhe që atëherë më është vënë në ndjekje. Më është vënë nga pas për të vënë gjobë.

Gjobë në çfarë kuptimi?

Në kuptimin që unë t'i thosha Zaganit, mos më ndiq nga pas, mos më ngacmo, thjesht për të më vënë presion. Zaganit ka qenë në kohën e tij, në Vlorë, ka qenë mbreti i portit, nuk mund t'i fliste asnjë njeri. Zaganit më ka penguar gjithë biznesin.

Juve ju është bllokuar një sasi, 86 mijë euro. Këto lekë a i keni pasur të justifikuar?

Këto lekë janë bllokuar me të vërtetë nga dogana e Durrësit, dhe nga policia e Durrësit në vitin 2012, dhe në bazë të verifikimeve që janë bërë, lekët kanë dalë, pas 1 muaj a 2 muaj janë zbllokuar. Prokurori ka qenë Edmond Kaloshin në bazë të verifikim-

it që më ka bërë të biznesit...

Ju çfarë biznesi keni?

Të fruta-perimeve, import eksport, Itali, Greqi të gjithë Evropën, kam 15 vjet me këtë biznes. Ky është urdhri i Edmond Kaloshit, t'ia çoj opozitës këto që të mësojë për shifrën që më është bllokuar, dhe i verifikuar dhe kontrolluar pikë për pikë nga zoti i asaj kohe, nga ish-nëndrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, z Agron Kuliçi.

Pra, këto lekë janë verifikuar atë kohë?

Po janë verifikuar, dhe i kanë verifikuar 2 muaj e gjysmë, sa kanë verifikuar deri në Itali për gjërat e mia...

Pse nuk janë deklaruar nga personi të cilit iu kapën?

Nuk e di, unë i kisha thënë personit të cilit iu kapën, të depononte lekët, puna e tij pse nuk e bëri, dhe ai u dënua me 2 milionë lekë të vjetër gjobë për mosdeklarim.

Ka qenë vetë z.Kuliçaj që ka firmosur ndryshimin e shumës?

Të të gjitha lekëve, të pastrisë sime, të të gjitha lekëve, ai z Kuliçaj.

Sa i takon pjesës së lekëve, destinacioni i tyre kush ishte?

Destinacioni i tyre ishte Italia, për blerje malli në Itali, për blerje për biznesin që kam.

Në akuzat fliete për pjesë të kundërligjshme...

I ke me fakte me letra të gjitha, që çdo gjë është verifikuar në kohën e opozitës.

Ju etiketoheni si kontingjent në qytetin e Vlorës

dhe etiketoheni dhe për një pengmarrje. Sa i vërtetë është ky informacion?

Në asnjë mënyrë nuk kam marrë peng askënd.

Si qëndron e vërteta se ju u akuzuat për këtë lloj akuze?

Kemi qenë fis në kohën e opozitës, kur drejtor ka qenë Artan Cuku dhe na kanë akuzuar për një pengmarrje, por e vërtetojmë me një shkresë të prokurorisë se kemi qenë dhe në një proces gjyqësor. Dhe në shkresën e prokurorisë nuk bëhet fjalë për pengmarrje, as të kemi marrë peng njeri.

Pra, kjo lloj akuze ka rënë?

Unë z.Enrik flas me letër, me fakte dhe jo si opozita. Këto janë fakte.

Po si ka ndodhur kjo çështje?

Thjesht, ky personi më ka pasur X lekë borxh dhe me akt noterie, nuk m'i solli dhe më thoshte t'i kam dhënë. Dhe në bazë të verifikimeve që ka bërë prokuroria u verifikua se zotëria ka lekët që nuk m'i ka dhënë akoma.

Duke qenë makina në qendër të vëmendjes, fliete për një person me inicialet A.D ose Ard Dalipi. E njihni ju, cila është lidhja juaj me këtë person?

Absolutisht në asnjë rast nuk e njoh dhe nuk kam të bëj fare me të.

Pra, ky person për të cilin përfliet nuk ka hipur asnjëherë në makinën tuaj tip "Audi"?

Tani unë them që nuk e njoh këtë person, dhe si mund të them që ky person ka hipur në makinën time?

Një prej akuzave të fundit që janë bërë nga ana e opozitës, janë ato për shefin e Postës Kufitare në Himarë? Keni pasur apo jo në lidhje me trafikun e drogës, duke qenë se akuzat janë, dhe është lidhje kriminale?

Po, është e vërtetë që opozita ditët e fundit, domethënë para dy ditësh ka nxjerrë një foto të tij me vël-lain tim. Tani që opozita sheh ëndrra me baronë droge, nuk është faj i askujt. Ky në fotografi, shefi i Postës Kufitare, z Sokol ka qenë në një festë me miq të mitë dhe janë ulur për të ngrënë diçka, dhe në foto po ta shohësh nuk ka ndonjë kontingjent, madje aty ka dhe nja dy këngëtarë, dhe në gjithë tavolinën nuk ka asnjë kontingjent kriminal. Ajo ka qenë një festë fetare dhe këtë ta shohë opozita dhe ta verifikojë.

Fotot me shefin e Postës i ke të tanishme apo të hershme?

Shumë, flasim për 8 vjet para, 9 vjet në mos bëj gabim, jemi njohur në një festë fetare. Nuk kemi absolutisht asnjë lidhje droge, asnjë gjë...

Në të njëjtat akuzat thuhet se ju dispononi rreth 68 mijë kanabis sativa në fshatrat e Vlorës që kanë përkujdesje të zv/shefit të komisaritit të Vlorës. Si mund të faktoni të kundërtën? Cili është reagi-mi juaj dhe a keni njohje apo lidhje me zv/shefin komisaritit?

As nuk e njoh dhe as nuk e di si quhet, ëndrrat e opozitës si gjithmonë vazhdojnë me përbaltjen e Habilajve, vazhdojnë të shohin filma me baronë droge dhe kjo me shumë është çështje politike me të cilën unë nuk kam fare lidhje. Nuk e kam idenë e sa mijë rrënjëve, janë ëndrra të ish kryeministrit që në darkë sheh ëndrra dhe ditën i thonë në kanale televizive dhe "Facebook"

Formula për llogaritjen e pensionit të pleqësisë, baza vitet e kontributeve

Pensionet, sa përfitoni sipas vitit që keni filluar punën

Llogaritjet për të punësuarit dhe të vetëpunësuarit

Llogaritja e pensionit të pleqërisë dhe masa e përfitimit për të punësuarit dhe të vetëpunësuarit përcaktohet nga vitet që personat që kanë kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore. Për llogaritjen duhet të: - individualizohen pagesat vjetore të punonjësve të punësuar ose të ardhurat e arritura nga të vetëpunësuarit; - llogariten kontributet e çdo viti në bazë të normës (33% për të punësuarit, 20% për vetëpunësuarit); - përcaktohet shtylla individuale që përfitohet duke mbledhur kontributet e çdo viti, rivlerësohet në mënyrë të përshtatshme në bazë të normës vjetore të kapitalizimit që rezulton nga ndryshimi mesatar pesëvjeçar në GDP (Produkti i Brendshëm Bruto) të përcaktuara nga INSTAT. Sipas ligjit në fuqi formula aplikohet në kolonën kontributive koeficienti i transformimit, i cili varion në varësi nga mosha e punëtorit në kohën e daljes në pension.

SHENBULL

Llogaritja është e thjeshtë. Po të marrim një punëtor, i cili ka filluar punën që nga viti 1996 dhe ka derdhur kontribute për rreth 6 mijë euro në vit për 20 vjet, që, së bashku me indeksimin arrijnë një total gjithsej të barabartë me 200 mijë euro. Për ta konvertuar në pension vjetor bruto, kjo shumë vetëm shumëzohet me koeficientin e konvertimit të moshës relative në të cilën punëtori ka arritur kështu e parë të pensioneve. Është e lehtë për të parë se si shuma e pensionit rritet me rritjen e moshës. Nëse punonjësi ka arritur moshën e daljes në pension prej 67 vjeç, do të marrë, në fakt, një shumë prej rreth 11,400 euro bruto vjetore (200,000 x 5.700% = 11,400 euro); nëse punonjësi ka arritur moshën e daljes në pension prej 70 vjeç, shuma do të rritet në 13,082 euro në vit (200,000 x 6,541% = 13,082 euro). Në përllogaritjen e pensionit, për çdo vit kur lind kjo e drejtë, i korrespondojnë koeficientët përkatës sipas moshës së



Foto ilustruese

Ky është muaji, kur mbi 30 mijë pensionistë duhet të paraqiten vetë në bankë dhe të deklarojnë se e tërhojnë pensionin e tyre. Kjo është një procedurë që bëhet 2 herë në vit. Në rast se nuk paraqitet vetë fizikisht, pensioni nuk kalon në llogaritë përkatëse të individëve. Rreth 30 mijë pensionistë duhet të paraqiten në bankën kur marrin pensionin e tyre për të bërë një deklaratë ku vërtetojnë se janë paraqitur vetë fizikisht për ta tërhequr atë. Kjo është një deklaratë që bëhet një herë në gjashtë muaj, si procedurë për të vërtetuar se i moshuari jeton. Në rast se nuk bëhet kjo deklaratë, pensionisti humbet të drejtën e përfitimit. "Pensionistët bëjnë një deklaratë, ku deklarojnë se e kanë marrë pensionin në rregull, nuk ka vërejtje dhe pas kësaj deklaratë pensioni gjenerohet nga

daljes, të cilat duke u shumëzuar me shumën e kontributeve, përcaktojnë pensionin vjetor. Sipas ligjit në fuqi

Emini: 30 mijë pensionistë tërheqin paratë në bankë

Pensionistët, deklarim në bankë që e tërheqin vetë pensionin



Zv. drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore Ali Emini

muaji tetor deri në 6 muajt e ardhshëm. Jemi në kushtet kur pensionistët që marrin pensionin në bankë duhet ta kishin bërë këtë deklaratë dhe ka disa për tyre që, ose duke mos qenë në Shqipëri, ose duke mos e vlerësuar

nga 1 janari 2012, për punonjësit që posedojnë vjetërsi kontributive për të paktën 18 vjet deri më 31/12/1995 do

nuk e kanë bërë këtë deklaratë" thotë Ali Emini për "Ora news". Zv. drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore Ali Emini sqaroi të gjithë ata që nuk kanë marrë pensionin suplementar. "Listë pagesat

të aplikohet sistemi i llogaritjes kontributive, i bazuar në kuotat e pensionit që i korrespondon vjetërsisë

bëheshin në mënyrë manuale dhe dërgoheshin në mënyrë manuale, por tani jemi në kushtet kur shërbimi i pagesës së pensioneve në banka u zgjerua dhe solli domosdoshmërinë e këtij portali. Përveç kësaj, çështja u koordinua dhe me një ditë pushimi që ishte dita e enjte dhe filloi gjenerimi i pagesave ditën e premte", thotë Emini. Për të vazhduar në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike, anëtarët madhorë të familjes duhet paraqiten çdo 3 muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjendjen social-ekonomike të familjes.

kontributive të maturuar. Duke filluar nga 01.01.2012 pensioni llogaritet ekskluzivisht me sistemin e llog-

PENSIONI

Po të marrim një punëtor, i cili ka filluar punën që nga viti 1996 dhe ka derdhur kontribute për rreth 6 mijë euro në vit për 20 vjet, që, së bashku me indeksimin arrijnë një total gjithsej të barabartë me 200 mijë euro.

aritjes kontributive për punëtorët që nuk kanë vjetërsi kontributive më 1 janar 1996. Për të ushtruar alternativën e opsionit është e nevojshme që punëtorët të kenë vjetërsi prej më pak se 18 vjet të kontributit të 31/12/1995 dhe mund të zbatohet në moment, si opsion, një vjetërsi kontributive më të paktën 15 vite, nga të cilat 5 që nga viti 1995. Të tilla fakultative nuk mund të ushtrohen nga ata që plotësojnë një vjetërsi kontributive të barabartë ose më të madhe se 18 vite deri më 31.12.1995.

LLOGARITJA

Për llogaritjen e pensionit të pleqërisë, sipas ligjit 104/2014, neni 18, i cili ndryshon nenin 32 të ligjit 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet si më poshtë: 1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. 2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social. 3. Shtesa do të jetë 1% për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 31 të ligjit 104/2014 (i cili ndryshon nenin 59 të ligjit 7703, datë 11.05.1993).

SHTESAT

Sipas nenit 33 të ligjit 104/2014, i siguruari, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie, sipas nenit 43 të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,5% të pensionit për çdo muaj që shtyn datën e daljes në pension dhe vazhdon të paguajë kontribute. Përfutuesi i pensionit të pleqërisë, që ndërpret pensionin, vazhdon të punojë dhe paguan kontribute, merr shtesë mbi pension në masën 0,5% për çdo muaj ndërprerjeje. Kjo shtesë llogaritet mbi atë masë pensioni që rezulton pas rritjeve dhe indeksimit që ka pësuar pensioni gjatë kohës së ndërprerjes.

Ky është ndryshimi i Kfundit në vendimin Nr.955, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike". Në vendimin e Këshillit të Ministrave thuhet, gjithashtu, se administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet social-ekonomike të familjes për përfitimin e ndihmës ekonomike. Ven-



Ndihma ekonomike, procedurat dhe dokumentet që duhen dorëzuar

dimi i Këshillit të Ministrave specifikon ndryshimet që janë bërë edhe për kategoritë që përjashtohen nga përfitimi. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë gjashtë mujore, familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme: a) Kryen ndar-

je të qëllimshme të anëtarëve të familjes, që jetojnë në të njëjtën shtëpi. b) Nuk tërheq ndihmën ekonomike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga dita e depozitimit në llogarinë bankare/kryerjes së pagesave nga Posta Shqiptare, për përfituesit e ndihmës ekonomike me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur

për shkaqe të arsyeshme si shëndetësore dhe fatkeqësi; c) Refuzon verifikimin e situatës social-ekonomike në familje. Refuzimi dokumentohet me procesverbal, sipas shprehjes së informacionit apo kryen deklarin të rremë mbi të dhënat e kërkuara në këtë vendim; d) Nuk deklaron ndryshimet e

situatës social-ekonomike në deklaratën e paraqitjes çdo tre muaj të familjes; dh) Refuzojnë përshirjen në kurset e formimit profesional ose refuzojnë ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislativacionit në fuqi për nxitjen e punësimit. Këshilli i Ministrave thekson se ky vendim botohet në "Fletoren zyrtare" dhe hyn në fuqi më datë 1 janar 2018.

Reagon vajza e familjes Salla: Shumë parash për këdo që jep informacion

ELBASAN

Banesa e një biznesmeni të njohur në Elbasan ka rënë pre e hajdutëve. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se në orët e para të mëngjesit të djeshëm, persona ende të paidentifikuar kanë hyrë në shtëpinë e Ylli Sallës në fshatin Mengel dhe kanë marrë kasafortën me para si dhe dy makina luksoze. Menjëherë pas sinjalizimit për bastisjen, blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Sipas hetuesve të çështjes, vjedhja ka ndodhur rreth orës 04:30 të së hënës. Policia ka sekuestruar pamjet e kamerave të sigurisë së bizneseve pranë banesës së biznesmenit, me qëllim rënien në gjurmët e agresorëve. Ndërkohë, burimet e mësipërme pohuan se dyshohet që vjedhja e banesës së Ylli Sallës ka qenë e mirorganizuar dhe e menduar deri në detaje. Mësohet se grabitësit kanë mundur të futen në shtëpinë e biznesmenit duke hapur derën kryesore, ndërsa çelësat e makinave i kanë marrë në tavolinat e paradhomës. Ndonëse në banesë ishin edhe pjesëtarët e familjes, asnjëri prej tyre prej tyre nuk ka dëgjuar lëvizjet e hajdutëve. Në janar të këtij viti biznesmeni Ylli Salla ka rënë pre e një tjetër ngjarjeje të rëndë, ku është dhunuar me sende të forta në ambientet e karburantit të tij në qytetin e Elbasanit.

Bastiset shtëpia e biznesmenit, hajdutët marrin kasafortën e 2 makina luksoze

Policia: Dyshohet se vjedhja ka qenë e mirëorganizuar



Biznesmeni Ylli Salla, i dhunuar në janar të këtij viti

DHUNIMI

Në janar të këtij viti biznesmeni Ylli Salla ka rënë pre e një tjetër ngjarjeje të rëndë. Ai është dhunuar me sende të forta në ambientet e karburantit të tij në qytetin e Elbasanit.



Makinat që iu vodhën biznesmenit Salla

Operacioni, të riut i bllokohen 45 mijë euro e 10 mijë dollarë

VLORË - Një 22-vjeçar nga Vlora i janë sekuestruar vlera monetare prej 44.900 euro dhe 9900 USD, pasi dyshohet se janë përfituar në mënyrë të paligjshme. "Në kuadër të plan-operacionit 'Vjeshtë 2017', lidhur me sekuestrimin e aseteve, të cilat rezultojnë të përfituara në mënyrë të paligjshme, Policia Vlorë ka bërë të mundur sekuestrimin e disa vlerave monetare. Konkretisht, janë sekuestruar 44.900 euro dhe 9900 USD, në posedim të shtetasi L.M., 22 vjeç, banues në Vlorë", thuhet në njoftimin e policisë. Materialet janë referuar në prokurori.

Vjedhja e banesës, deputeti Boçi: Krimi në Elbasan është trimëruar se mbrohet nga Rama

Pas vjedhjes së banesës së biznesmenit Ylli Salla, ka reaguari deputeti i Partisë Demokratike, Luçiano Boçi. Me anë të një statusi në rrjetin social "Facebook", Boçi ka bërë me dije se krimi në Elbasan nuk mund të luftohet, duke sulmuar gjykatat dhe prokurorinë.

REAGIMI I LUÇIANO BOÇIT:

Krimin në Elbasan nuk i vihat kapak floriri, duke drejtuar gishtin tek prokuroria apo gjykata, por duke i mbyllur portat atij. As duke nxjerrë në rrugë të madhe ato që përballen përditë dhe rrezikojnë. Ngjarja e mëngjesit të sotëm, grabitja e biznesmenit Ylli Salla, dëshmon se krimi në Elbasan është trimëruar e është bërë më i fortë se kurrë dhe jo rastësisht. Mbrojtja publike që u bën kryeministri



Deputeti i PD-së, Luçiano Boçi

simboleve të krimit të organizuar dhe sulmet publike të tij ndaj drejtësisë, e frymëzojnë. Goditet personi që pak kohë më parë u godit fizikisht nga miqtë e Edi Ramës, të cilët administrojnë fabrikën e peshkut, ndotësen më të madhe të Labinot Fushës e është në proces gjyqësor

me ta. Po policia 'e re'? Rri e vështron dhe i shkel syrin krimin se Ylli është 'i skeduar'. I skeduar si i djathhtë! Kjo është lufta e vërtetë që bën ky shtet e kjo qeverisje. Luftë ndaj biznesit e njerëzve të thjeshtë. Ndërsa krimin e ka partner në "beteja".



Atentati në Shëngjin, policia: Në shënjestër, i riu Florian Dushku

LEZHË - Një ditë pas atentatit të ndodhur në qendër të qytetit të Shëngjinit, policia e Lezhës ka shogëruar dhe marrë në pyetje 18 persona. Mësohet se blutë dhe forcat e FNSH-së së Shkodrës kanë ushtruar kontroll në 7 banesa dhe ambiente me qëllim gjetjen e autorëve të krimit, apo provave që hedhin dritë mbi këtë ngjarje. Ndërkohë, janë këqyruar dhe administruar pamjet filmike të kamerave të sigurisë pranë vendit të ngjarjes. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, burime nga policia lokale pohuan se dyshohet se objekt i sulmit me armë zjarri të ketë qenë shtetasi Florian Dushku, ndërsa shtetasi Samet Berçaj u plagos aksidentalisht (ndodhë rastësisht në vendngjarje). Po sipas policisë, autorë të plagosjes së dy të rinjve janë dy persona dhe se po punohet intensivisht për identifikimin dhe arrestimin e tyre. Ndërkaq, burime konfidenciale pohuan se dyshohet që atentati i së dielës është vijim i një konflikti që prej fushatës zgjedhore të qershorit të këtij viti. Florian Dushku është një nga të plagosurit që u godit me 25 qershor me qytë pistolete. Ngjarje që dërgoi asokohe në Lezhë edhe Ilir Metën, i cili deklaroi që kishte shkuar atje për të mbrojtur votën e lezhjanëve.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 25.10.2017 ne oren 16.00 ne zyrën e permbaresit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adresë ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Apartament" me sip.68 m², me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjia 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5, Ure Valjgurorë Berat.Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 1,568,000 (nje milion e pesëqind e gjatëdhjetë e tete mije) lekë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 26.10.2017 ne oren 16.00 ne zyrën e permbaresit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adresë ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Apartament" me siperfaqe 52.01 m², me volum 1, faqe 175, numer pasurie 1/214+2-15, ne zonen kadastrale 1664, me adresë Lagjia "Puntori", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushë Krue.Cmimi ne ankand te pare eshte ne vleren 1,945,244.8 (nje milion e nenteqind e dyzet e pese mije e dyqind e dyzet e kater pike tete) lekë.

NJOFTIM

Studio Përmbarimore **Zyber SHEHU** zhvillon ankandin e I (Parë) për pasurinë:
a. Pasuria Nr.20/55+1-17, vol.5, faqe 87, Z.K.8571, e apartament, me siperfaqe totale 74m², e ndodhur në Lagjen "Kongresi" Lushnje, cmimi 2.400.000 lekë.
Ankandi zhvillohet ne date 25.10.2017 në ambientet e Studios Përmbarimore **Zyber SHEHU** me adresë: Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Cel.0682089339, osë adresën e-mail:shehuzyber@yahoo.com

TIRANE - Policia e Shtetit u bën thirrje të gjithë qytetarëve të jenë të kujdesshëm me blerjet 'online', pasi kohët e fundit është konstatuar një rritje e numrit të mashtrimeve të kryera nëpërmjet internetit. "Informojmë qytetarët dhe subjektet private se nga strukturat e specializuara



Policia e Shtetit

Policia e Shtetit, qytetarëve: Kujdes me blerjet në internet, mund të vidheni me anë të mashtrimit

të Policisë së Shtetit për Hetimin e Krimeve Kompjuterike, po merren të gjitha masat për parandalimin e rasteve të ngjashme, por edhe evidentimin e goditjen e autorëve për rastet e ndodhura. Duke u nisur nga fakti se këto ngjarje kanë si qëllim vjedhjen e fondeve të

llogarive bankare nëpërmjet mashtrimit, u kërkojmë qytetarëve dhe subjekteve private të bëjnë kujdes për sa i përket ekspozimit të të dhënave të tyre bankare në mjediset e jetës së përditshme, por edhe kur marrin kërkesa të ndryshme gjatë periudhës që ndodhen duke

llogaruar në internet", - thuhet në njoftimin e policisë. Policia sqaron se çfarë duhet të bëjnë qytetarët në rast se marrin kërkesa për kryerjen e pagesave në llogari bankare të ndryshme nga ato që i kryejnë zakonisht. "Duhet të verifikoni parakishtë me mjete të tjera

komunikimi (telefon, faks etj.) nëse llogaria e re i përket vërtetë partnerit tuaj tregtar. Gjithashtu, kujdes duhet të bëhet me dhënie e kodeve të hyrjes për llogaritë e tyre të rrjeteve sociale, postës elektronike si dhe çdo program tjetër, i cili mundëson hyrjen nëpërmjet kodeve të sigurisë", sqarohet ndër të tjera.

SARANDË/ Autori: Nuk doja ta lëndoja, situata më doli jashtë kontrollit

Nxënësi 17-vjeçar plagoset me thikë në shkollë nga shoku i tij

Shërri mes gjimnazistëve nisi për një femër

Arbër Sulo

SARANDË

Një ngjarje e rëndë është shënuar dje në qytetin e Sarandës, ku dy nxënës të një gjimnazi janë konfliktuar me njëri-tjetrin dhe për pasojë, njëri mbeti i plagosur. Burime pranë policisë bëjnë me dije se dy djemtë që janë konfliktuar janë identifikuar si shtetasit Kastriot Xhanga dhe Kostandin Bodini, të dy 17 vjeç. Në sherr e sipër, Xhanga ka nxjerrë nga xhepi një thikë, të cilën ai e mbante me vete dhe ka qëlluar në sup shokun e tij, Kostandin Bodini u dërgua menjëherë në spital për të marrë ndihmën e parë, ndërsa fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Burime e lartpërmendura sqaruan më tej se shërri mes tyre kishte nisur për një femër, ndërsa autori i plagosjes u shoqërua menjëherë në komisarjat.

NGJARJA

Ngjarja e rëndë ndodhi dje gjatë orëve të para të mëngjesit, ku dy nxënësit e vitit të tretë janë zënë në klasë. Sipas policisë, shërri mes dy të rinjve nisi në am-



I plagosuri, Kostandin Bodini

bientet e "Shkollës Ekonomike", në lagjen "Nr.3", të qytetit të Sarandës. Burime pranë uniformave blu sqaruan se konflikti mes tyre kishte nisur për shkak të një femre. Fillimisht, konflikti mes tyre është vënë re nga mësuesja e cila ndodhej në klasë. Ajo ka ndërhyrë me

njëherë për të shuar sherrin, por vuri re se nxënësi i kasës së saj ishte plagosur me thikë. E ndodhur në këtë situatë, mësuesja ka lajmëruar menjëherë policinë ndërsa dërgoi në spital edhe të plagosurin Kostandin Bodini. Ky i fundit ka marrë dy plagë në trup

dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. "Shërbimet policore kanë shkuar në vendngjarje dhe nga verifikimi ka rezultuar se shtetasi Kostandin Bodini, 17 vjeç dhe Kastriot Xhanga, 17 vjeç janë grindur me njëri-tjetrin për motive të dobëta duke përdorur edhe mjete të ftohta prerëse. I dëmtuar ka mbetur shtetasi K.B., i cili po merr ndihmën mjekësore në Spitalin e Sarandës dhe është jashtë rrezikut për jetën. Policia ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale nga vendi i ngjarjes mjatim prerës tip (biçaq). Gjithashtu, ka shoqëruar në ambien-

SHOQËRIMI

Kostandin Bodini u qëllua dy herë me thikë në sup nga shoku i tij, Kastriot Xhanga. Ky i fundit, pas akteve të rëndë që kreu u shoqërua menjëherë në komisarjat e policisë për të dhënë deklaratimet e tij. Ndërsa i plagosuri ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

tet policore shtetasin K.Xh., dhe po punon për sqarimin e plote të grindjes midis dy të rinjve", thuhet në njoftimin e policisë.

DËSHMITË

Burime pranë policisë sqaruan dje se të dy të rinjtë, të cilët u përfshinë në konflikt kanë qenë në të njëjtën linjë për tregimin e motivit të ngjarjes së rëndë. Të dy kanë pohuar se shërri nisi për shkak të një femre, që secili prej tyre e konsideronte si të tijen. Nga ana tjetër, autori i plagosjes ka pohuar se nuk ka dashur ta lëndonte shokun e tij, por se situata i doli jashtë kontrollit.

ITALI



Shqiptari merret peng për borxhin e pashlyer

Një shqiptar në Itali është marrë peng për një borxh prej 13 mijë eurosh. Rrëfimi i torturave nga ana e shqiptarit 47-vjeçar, identiteti i të cilit nuk bëhet i ditur, është bërë shkak që të shkatërrrohet një bandë e rrezikshme në Itali, që vepron në disa zona. Banda përbëhet nga 4 shqiptarë dhe një italian. Edhe pasi u lirua si peng, shqiptari mori kërcënime me jetë. Gjithçka nisi një vit më parë kur 47-vjeçari kërkonte të hapte një biznes në Romë dhe për këtë i duheshin para borxh. Ai ua kërkoi bashkëkombësve, të cilët më pas e morën peng. Pasi u mori 7 mijë euro, në fillim çdo gjë shkonte mirë kur ai u kthente nga 700 euro në muaj, por më pas për shkak të vështirësive, s'mundi t'i paguante më dhe borxhi u rrit me 13 mijë euro. Më pas filluan kërcënimet me vdekje ndaj tij nga huadhënësve, të cilët e morën shqiptarin dhe e dërguan në një vend të izoluar në Pavona. "Më lidhën në një karrigje dhe më godisnin me shkelma në të gjithë trupin. Nuk më dhanë as bukë, as ujë për tri ditë. Më thanë se nëse nuk i ktheja borxhin, do të më groposnin 6 metra nën tokë", ka thënë ai. Më justifikimin se do merret një shok në telefon t'i sillte paratë, lajmëroi policinë e cila arriti ta lironte në kohë.

unicef for every child

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF) Albania Country office

CALL FOR EXPRESSION OF INTEREST

The UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF), ALBANIA Country Office, would like to announce a Call for Expression of Interest addressed to Civil Society Organizations (CSOs) for a prospective partnership with UNICEF Albania Country Office in the implementation of the activity on *Institutional capacity development for the enforcement of the Universal Salt Iodization Law in Albania*.

For further details on the required partnership and on how to respond to the Call, please consult UNICEF Albania (www.unicef.org/albania) and UN Albania (www.un.org/al) websites.

Applications from interested CSOs must be delivered to UNICEF Tirana Office not later than **31 October, 2017, at 16:30 hr**.

Applications must be submitted in a sealed envelope, clearly marked **"EQI-ALBA-2017-001 - CSO Call for Expression of Interest - USI Law Enforcement"**.

at the following address:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rruga "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë,
Tiranë, Albania
Tel.: +355 42 273 335/6/7/8/9; fax: +355 4 224 3775 /6
Website: www.unicef.org/albania

Studio Perbarimore "SHKRELA" do të zhvillojë Ankandin e dytë për pasuritë:

- a) "Aparamenti", me sipërfaqe totale 77.36 m², me nr. Pasurie 6/121+1-2, e ndodhur në zonën kadastrale Nr. 8534, Volumes 5, Faqe 138, e ndodhur në Lagja 16 Prilli, Fier, në pronësi të Vasillaq Tefi Zhaka. Cmimi me të cilin fillon shitja e kesaj pasurie është në vlerën 16,028.88 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njetzet e tetë pike tetëdhjetë e tetë) Euro.
 - b) "Aparamenti", me sipërfaqe totale 62.2 m², me nr. Pasurie 6/121+1-4, e ndodhur në zonën kadastrale Nr. 8534, Volumes 5, Faqe 140, e ndodhur në Lagja 16 Prilli, Fier, në pronësi të Vasillaq Tefi Zhaka. Cmimi me të cilin fillon shitja e kesaj pasurie është në vlerën 12,887.84 (dymbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e shtatë pike tetëdhjetë e katër) Euro.
 - c) "Aparamenti", me sipërfaqe totale 74 m², me nr. Pasurie 6/121+1-4, e ndodhur në zonën kadastrale Nr. 8534, Volumes 5, Faqe 148, e ndodhur në Lagja 16 Prilli, Fier, në bashkëpronësi të Vasillaq Tefi Zhaka dhe Lefteri Vangjel Zhaka. Cmimi me të cilin fillon shitja e kesaj pasurie është në vlerën 15,332.8 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy pike tetë) Euro.
 - d) "Aparamenti", me sipërfaqe totale 51 m², me nr. Pasurie 116/71+1-31, e ndodhur në zonën kadastrale Nr. 2291, Volumes 29, Faqe 174, e ndodhur në Kryemadheni, Kavajë, në pronësi të Vasillaq Tefi Zhaka. Cmimi me të cilin fillon shitja e kesaj pasurie është në vlerën 13,440 (trembëdhjetë mijë e katërdhjetë e dyzetë) Euro.
- Pasuritë janë në bashkëpronësi të Vasillaq Zhaka dhe Lefteri Zhaka dhe të hipotekuara në favor të bankës.
- Ankandi i dytë zhvillohet me datë 26.10.2017, ora 16.00 në ambientet e Studios Perbarimore Shkrele me Adresë:Rruga Blv."Zogu i I", Pall. "Agjimi", H 2, K 3, Ap. 5, Tirane.

Goditi Idriz Kariqin 8 herë me thikë në shpinë, duke e lënë të vdekur në vend

Ina Allkanjari

KAVAJE

Gjykata e Kavajës dënoi dje me burgim të përjetshëm të pandehurin Musa Saraçi, i akuzuar për grabitjen dhe ekzekutimin me thikë të viktimës Idriz Kariqi, rreth një vit më parë. Ngjarja ka ndodhur më 14.12.2016 në qytetin e Kavajës, ku i pandehuri Saraçi mori peng dhe më pas goditi disa herë me thikë taksistin Kariqi, ndërsa makinën e tij e shiti në një varrezë makinash për 27 mijë lekë të rinj. Sipas dosjes së prokurorisë së Kavajës, nga hetimet ka rezultuar se Saraçi, paraditen e datës 14.12.2016 ka marrë si shërbim taksit mjetin e drejtuar nga viktimë Kariqi, në vendin pranë spitalit të Kavajës. I pandehuri, një natë para krimit kishte qenë duke luajtur në lojëra fati dhe kishte shpenzuar paratë që i kishte marrë pa dënimin e familjes së tij. Që në momentin që ka hipur në taksit, ai ka pasur qëllim për të marrë paratë e taksistit. Pranë fshatit Greth, ai i ka kërkuar taksistit të ndalojë makinën dhe, nën kërcënimin e një thike i ka kërkuar atij që t'i japë paratë që kishte me vete. Taksisti Kariqi ka nxjerrë paratë që kishte me vete, rreth 1900 lekë të reja, por këto kanë qenë të pamjaftueshme për autorin, i cili e ka goditur disa herë me thikë, duke e lënë të vdekur në vend. Më pas, autori ka marrë makinën e viktimës dhe ka ecur disa minuta, derisa makina është rrëzuar në një kanal dhe është dëmtuar.

ARRESTIMI

Autori i dyshuar ka rrëfyer në polici se pasi kanë arritur në fund të rrugës së shtruar, e ka goditur tetë herë me thikë në pjesën e përparme dhe shpinës, duke e lënë të vdekur në vend taksistin Kariqi. Pasi kanë parë kamerat, blutë kanë identifikuar Musa Saraçin, i cili

Kavajë, vrau taksistin, burg përjetë për Musa Saraçin

Prokuroria: La lekët në lojëra fati, i shiti makinën për 27 mijë lekë

shfaqet brenda në taksit me viktimën. Më tej, prokuroria ka nisur hetimet për të zbardhur ngjarjen dhe arsyen e krimit. "Duke qenë se mjete nuk mund të lëvizte, i pandehuri ka telefonuar një të njohurin e tij që posedon një servis makinash, të cilit i ka thënë se kishte një makinë të prishur dhe donte ta shiste për skrap. I pandehuri Saraçi ka shkruar në këmbë deri te servisi i të njohurit të tij dhe kanë bërë "pazar" që makinën ta shiste për 27 mijë lekë të reja. Pasi ka marrë paratë, autori është larguar dhe është arrestuar pas dy ditësh, në vijim të veprimeve procedurale hetimore", sqaron prokuroria. Pas arrestimit, Musa Saraçi, me banim në Gose të Kavajës ka pranuar autorësinë e krimit dhe ka treguar të gjithë ngjarjen dhe vendin ku e kishte hedhur trupin e viktimës. Ndërkohë gjatë shqyrtimit gjyqësor, avokati mbrojtës i Saraçit pretendoi se ai kishte probleme të çrregullimit mendor. Një pretendim, i cili u rrëzua nga akti i ekspertimit, pasi i pandehuri jo vetëm se nuk ishte me probleme mendore, por këtë krim e kishte planifikuar në detaje duke ndjekur për disa ditë lëvizjet e taksistit Idriz Kariqi. Pas afro 8 muaj proces hetimi dhe gjykimi, Prokuroria e Kavajës kërkoi dënimin e të pandehurit Musa Saraçi me burgim të përjetshëm, kërkesë e cila u pranua nga ana e gjykatës.



I pandehuri, Musa Saraçi



SHITJA E TAKSISË

"Duke qenë se mjete nuk mund të lëvizte, i pandehuri ka telefonuar një të njohurin e tij që posedon një servis makinash, të cilit i ka thënë se kishte një makinë të prishur dhe donte ta shiste për skrap. I pandehuri Saraçi ka shkruar në këmbë deri te servisi i të njohurit të tij dhe kanë bërë "pazar" që makinën ta shiste për 27 mijë lekë të rinj", -sqaron prokuroria.

VRASJA

Pranë fshatit Greth, Musa Saraçi i ka kërkuar taksistit të ndalojë makinën dhe, nën kërcënimin e një thike i ka kërkuar atij që t'i japë paratë që kishte me vete. Taksisti Kariqi ka nxjerrë paratë që kishte me vete, rreth 1900 lekë të rinj, por këto kanë qenë të pamjaftueshme për autorin, i cili e ka goditur disa herë me thikë, duke e lënë të vdekur në vend.

Krimet e Rënda shfaqin pamjet e marra nga kamera e sigurisë

Atentati brenda burgut, prokuroria anulon alibinë e Kolaverit

60 minuta e ndajnë Ergys Kolaverin nga fajësia apo pafajësia për akuzën e vrasjes për gjakmarrje e mbetur në tentativë. Në seancën e së hënës në Gjykatën e Krimeve të Rënda, u transmetuan pamjet e marra nga një kamera sigurie në një rrugë pranë banesës së kryebashkiakut të Kamzës, ku shfaqet Kolaveri në një lokal. Sipas Kolaverit dhe avokatit të tij Samjir Visha, këto pamje janë xhiruar në të njëjtën kohë kur ka ndodhur ngjarja në burgun e Vaqarrit, ku u qëllua me armë snajper brenda ambi-

enteve të burgut, ngjarje për të cilën akuzohet Kolaveri, raportoi Top Channel. Por nga ana tjetër Prokuroria e Krimeve të Rënda, pretendon se pamjet në kamerën e sigurisë janë një orë para ngjarjes. Në lidhje me këtë, avokati i Kolaverit pretendon se pajisjes, që regjistron pamjet filmike, nuk i është ndryshuar ora, dhe për këtë arsye ora në video shënon një orë mbrapa dhe jo një orë më parë, siç ndryshon ora verore. Pra, janë këto 60 minuta që, nëse vërtetohen që nuk janë ndryshuar i japin pafajësinë Ergys Kolaverit, në të kundërt rrezikon dënimin për vrasje për shkak të gjakmarrjes e mbetur në tentativë. Ergys Kolaveri akuzohet se më 30 korrik të vitit 2016, ka qëlluar me një armë snajper brenda ambienteve të burgut të Vaqar-

rit, me qëllim për të vrarë Gazmir Daci që ndodhej i paraburgosur në atë burg. Nga ngjarja mbeti i plagosur gabimisht një tjetër i paraburgosur: Gazmir Daci akuzohet se ka vrarë vëllain e Ergys Kolaverit, si dhe ka plagosur rëndë vëllain tjetër dhe për këtë arsye prokuroria beson se Ergys kishte organizuar vrasjen e Dacit në shenjë gjakmarrjeje.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivën e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,388,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10:00 – 13:00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraparakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutyesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivën e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **16 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

FORCIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI

THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME

"Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri", program që financohet nga Qeveria Suedeze dhe që asiston zbatimin e reformës së policimit në Komunitet në Shqipëri, shpall **Thirrjen Nr.1 për Aplikime për Grante**.

Organizata Joffitpurësë (OJF), konsorciume dhe Organizata me Bazë Komunitare të cilët dëshirojnë të aplikojnë për grante nën Skemën e Granteve të këtij Programi, janë të ftuar të paraqesin projekt-propozime në kuadër të Thirrjes Nr. 1, e cila do zbatohet në qarqet **Durrës, Shkodër dhe Fier** dhe do të qëndrojë e hapur nga data **23 Tetor deri në datën 19 Nëntor 2017, ora 17:00**. Inkurajohen të aplikojnë organizata me seli në qarqet e mësipërme dhe projekt-propozimet të përfshijnë jo vetëm Bashkitë Qendër Qarku (Durrës, Shkodër, Fier) por dhe në bashkitë e tjera (Krujë, Malësi e Madhe, Lushnjë, etj.), apo njësitë administrative përbërëse.

Për organizatat të cilat nuk kanë seli në këto qarqe, si kusht detyrues për aplikim në këtë thirrje, është bashkë-aplikimi me një organizatë lokale/aktivistë lokale duke nënshkruar paraprakisht një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit.

Programi do të ofrojë dy lloj grantesh:

- Grante deri në **15,000 €** (2 për qarkun Shkodër, 1 për qarkun Durrës dhe 1 për qarkun Fier) do të jepen për projekt-propozime që synojnë a) fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve të koalicioneve me bazë komunitare me synim përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me Policinë së Shtetit dhe komuniteteve vendore si dhe rritjen e besimit të ndërsjelltë dhe; b) Përmirësimin e ndërveprimit mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë lokalë, anëtarë të mekanizmave lokale të referimit, për rritjen e cilësisë së masave parandaluese dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Periudha e zbatimit të projektit: deri në 18 muaj
- Grante deri në **5,000 €** (nga 2 grante për secilin qark) do të jepen për projekt-propozime që synojnë krijimin dhe konsolidimin e partneriteteve ndërmjet policisë, institucioneve vendore dhe komuniteteve duke pasur në fokus rritjen, si iniciativa në fushën e zgjidhjes së konflikteve, ndërgjegjësimin, pasojat e përdorimit të drogave dhe substancave narkotike, sigurinë në trafikun rrugor, bullizmin dhe krimin kibernetik, trafikimin e qenieve njerëzore, krimet homofobike, etj; me theks të veçantë në masat parandaluese. Periudha e zbatimit të projektit: deri në 7 muaj

Projekt-propozimet duhet të plotësohen sipas Formularit të Aplikimit dhe Udhëzuesit për Aplikime që mund të shkarkohen nga linku <http://www.cp-project.al/web/grants> dhe do të dorëzohen elektronikisht në adresën grants@cp-project.al.

Për më shumë detaje referohuni në: <http://www.cp-project.al/>



Ekspertët: Viza turistike nuk ju lejon të jetoni e të punoni në Shtetet e Bashkuara

Lotaria Amerikane, kriteret që ju kualifikojnë *"Kujdes, ja rastet kur penalizoheni"*

Voltiza Duro

P prej datës 18 tetor kanë rifilluar aplikimet për Lotarinë Amerikane për të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë e të punojnë në "tokën e premtuar". Por, Ambasada Amerikane, pas një defekti në faqen e aplikimit për DV-2019, njoftoi se regjistrimet e bëra para 18 tetorit konsiderohen si të pavlefshme dhe duhen ribërë edhe njëherë, si dhe theksojnë faktin që nëse një person aplikon 2 herë, do të skualifikohet. Afati i fundit kur kandidatët mund të regjistrohen është 22 nëntori. Nderkaq, në faqen zyrtare të Ambasadës Amerikane që operon në Shqipëri, aplikantët po drejtojnë një sërë pyetjesh për paqartësitë që hasin.

MARTESAT

Specialistët bëjnë me dije se nëse një person është i martuar dhe aplikon, duhet të përfshijë edhe familjen, pra bashkëshortin edhe fëmijët, gjithmonë nëse keni fëmijë. Po ashtu, edhe bashkëshortja ka të drejtë të aplikojë, sërish duke përfshirë familjen, çka i rrit shanset për të fituar. Ndërsa, për të gjithë ata parterë që bashkëjetojnë me njëri-tjetrin por nuk kanë bërë celebrim, duhet që secili të aplikojë me vete, pa e përfshirë tjetrin, pasi kanë statusin "Beqar". Nëse kandidatët përzgjidhen, e dëshirojnë të bëjnë celebrimin, duhet të njoftojnë KÇ për ndryshimin e statusit dhe shtimin e bashkëshortit/es. "Prindi nuk ka nevojë të përfshijë fëmijën mbi 21 vjeç tek aplikimi i tij, por nëse e përfshin, nuk skualifikohet", - thuhet në faqen zyrtare të Ambasadës Amerikane.

ARSIMIMI DHE EKSPERIENCA NË PUNË

Ligji dhe rregullat e Emigracionit të Shteteve të

Specialistët bëjnë me dije se nëse një person është i martuar dhe aplikon, duhet të përfshijë edhe familjen, pra bashkëshortin edhe fëmijët, gjithmonë nëse keni fëmijë. Po ashtu, edhe bashkëshortja ka të drejtë të aplikojë, sërish duke përfshirë familjen, çka i rrit shanset për të fituar.

Bashkuara kërkojnë që çdo aplikant duhet të ketë të paktën një arsim të shkollës së mesme ose ekuivalentin e saj, ose brenda pesë viteve të fundit të ketë dy vjet përvojë pune në një profesion që kërkon përvojë ose trajnim të paktën dy vjet. Një "arsimim i shkollës së mesme ose ekuivalente" përkufi-

zohet si përfundimi me sukses i një kursi dymbëdhjetëvjeçar fillor dhe të mesëm në Shtetet e Bashkuara ose përfundimin e suksesshëm në një vend tjetër të një kursi arsimi zyrtar të krahasueshëm me fillorin dhe të mesmen të një shkollë në arsimin e mesëm në Shtetet e Bashkuara. Vetëm kurset zyrtare të studimit e përbushin këtë kërkesë, kurset e korrespondencës, me kohë të pjesshme, ose certifikata të ngjashme (të tilla si me kohë të pjesshme G.E.D.) nuk janë të pranueshme. "Nëse ju keni një shkollë 2 ose 3-vjeçare profesionale, pra jo shkollë të mesme, e cila nuk ju jep të drejtën e vazhdimit të studimeve të larta, ju nuk jeni i kualifikueshëm. Gjithashtu, nëse aplikanti ka marrë një dëftesë përkurie me kohë të pjesshme, nuk kualifikohet për lotarinë, me përjashtim të rasteve kur disponon edhe një diplomë që dëshmon përfundimin e studimeve të larta", - theksohet në faqen zyrtare të ambasadës. Ndërkaj, ekspertët bëjnë me dije se mund të përdoret e njëjta fotografi që është përdorur për DV-2019, por nëse aplikanti bën regjistrimin me fotografinë e programit të lotarisë DV-2018, do të skualifikohet. "Ju mund të bëni fotografinë edhe me aparat celular që të ketë një cilësi të fotos. Nëse keni 'Microsoft Office Picture Manager' ose program tjetër editues, ju mund të editoni fotografinë fillimisht duke e bërë katrorë (crop) e më pas duke e 'resize' në përmasat 600x600 piksel", - sqarojnë ekspertët.

ARSIMIMI

"Nëse ju keni një shkollë 2 ose 3-vjeçare profesionale, pra jo shkollë të mesme, e cila nuk ju jep të drejtën e vazhdimit të studimeve të larta, ju nuk jeni i kualifikueshëm. Gjithashtu, nëse aplikanti ka marrë një dëftesë përkurie me kohë të pjesshme, nuk kualifikohet për lotarinë, me përjashtim të rasteve kur disponon edhe një diplomë që dëshmon përfundimin e studimeve të larta", - theksohet në faqen zyrtare të ambasadës. "Ju mund të bëni fotografinë edhe me aparat celular që të ketë një cilësi të fotos. Nëse keni 'Microsoft Office Picture Manager' ose program tjetër editues, ju mund të editoni fotografinë fillimisht duke e bërë katrorë (crop) e më pas duke e 'resize' në përmasat 600x600 piksel", - sqarojnë ekspertët.

piksel", - sqarojnë ekspertët. Në faqen zyrtare në "Facebook", Ambasada Amerikane shpjegon për aplikantët se nëse arrijnë të përzgjidhen, tarifa e aplikimit për vizë për një person është 330 dollarë, vizita mjekësore shkon 205 dollarë dhe pasi kandidati ka marrë vizën, 220 dollarë është shu-

ma që duhet paguar për lëshimin e 'Green Card'. Por, gjithashtu bëhet me dije se këto tarifa mund të pësojnë ndryshime që nuk varen nga ambasada. Vetëm aplikimi për lotarinë është falas.

VIZAT TURISTIKE

"Si zyrtarë të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe si oficerë konsullorë, autoriteti ynë vendimmarrës mbi vizat - si për lëshimet, edhe për refuzimet - është tërësisht i lidhur me ligjin e Shteteve të Bashkuara mbi imigracionin, me saktësisht Akti i Imigracionit dhe Nënshetësisë. Sipas Aktit të Imigracionit dhe Nënshetësisë (AIN), neve na duhet të konsiderojmë çdo aplikant vizash joimigruese si një person që synon imigracionin në Shtetet e Bashkuara, pra si një imigrant të mundshëm, përveç rastit kur ata provojnë që nuk janë të tillë. Kjo është një pengesë ligjore e domosdoshme, tepër strikte, që duhet tejkaluar. Neve na duhet të shqyrtojmë çdo çështje për vizë individualisht. E thënë ndryshe, çdo person duhet të dëshmojë që ai ose ajo i plotëson kërkesat për kualifikim për kategorinë e vizës dhe të ketë lidhje të forta me një rezidencë jashtë Shteteve të Bashkuara. Për shkak se secili person ka rrethanat e tij unike, ne nuk vijmë dot në të njëjtin konkluzion për çdo individ", - citojnë specialistët. Ata gjithashtu theksojnë se viza turistike ka për qëllim një qëndrim për një kohë të shkurtër në SHBA - viza turistike nuk është për të jetuar

në SHBA dhe as për të punuar atje. Përndryshe, individit mund të gjendet i papranueshëm sipas ligjit të imigracionit. Në përgjithësi, kandidatit duhet të qëndrojë për aq kohë sa ka deklaruar në aplikimin e tij për vizë. Gjithashtu, brenda një viti nuk mund të qëndrojë më shumë se gjashtë muaj në total. Me vizë turistike është e ndaluar të punojë në SHBA. Nëse oficeri i imigracionit ngre dyshime që qëllimi i vizitës nuk është turistik, por për punë, atij mund t'i revokohet viza. Zyrtarët e kufirit të Shteteve të Bashkuara përcaktojnë se sa kohë mund të qëndroni në Shtetet e Bashkuara. Për shumicën e mbajtësve të vizave të vizitorit (B1/B2), koha maksimale e qëndrimit është në përgjithësi gjashtë muaj deri në një vit kohor. Studentët, vizitorët e programeve të shkëmbimit dhe punëtorët e përkohshëm janë në përgjithësi të pranuar për kohëzgjatjen e statusit.

Pavarësisht nga kjo, për të shmangur në të ardhmen problemet me vizën apo me hyrjen në Shtetet e Bashkuara, qëllimi dhe koha e qëndrimit në Shtetet e Bashkuara duhet të jetë në përputhje me çfarë kandidati ka thënë në aplikimin për vizë. Qëndrimi përtej afatit të lejuar nga Departamenti i Sigurisë Kombëtare, apo qëndrimi jashtë statusit në SHBA është shkelje e ligjit të imigracionit të SHBA-ve dhe mund ta bëjë kandidatin të papranueshëm për vizë në të ardhmen.

Viza turistike ka për qëllim një qëndrim për një kohë të shkurtër në SHBA - viza turistike nuk është për të jetuar në SHBA dhe as për të punuar atje. Përndryshe, individit mund të gjendet i papranueshëm sipas ligjit të imigracionit. Në përgjithësi, kandidati duhet të qëndrojë për aq kohë sa ka deklaruar në aplikimin e tij për vizë.

15 vjet News 24

Presidenti Irfan Hysenbelliu:

Ky përvjetor mishëron pasionin, përpjekjet e qindra djemve e vajzave që i dhanë shpirtin kësaj risie që do mbërthente shqiptarët para ekranit dhe do bëhej modeli për shumë media të tjera. Në këto vite ia kemi dalë ta rrisim për ta bërë më modern, më të pavarur dhe të paanshëm, historia frymëzuese e këtyre viteve është modeli i së ardhmes. Një televizion që i shërben më shumë shqiptarëve.

TELEVIZIONI MË I MADH INFORMATIV NË VEND FESTON PËRVJETORIN
MES QINDRA TË FTUARVE NË PALLATIN E KONCERTEVE

15-vjetori i "News 24", presidenti Hysenbelliu: Investim për shoqërinë, zëri i të pafuqishmit!

15 vjet më parë, nisi transmetimin "News 24", televizioni informativ me shikueshmërinë më të lartë në Shqipëri. Me një histori të pasur tashmë, "News 24" arriti të ndryshojë transmetimin e lajmit në median televizive në Shqipëri. Në fokus të televizionit ka qenë gjithmonë shpejtësia dhe paanshmëria në transmetimin e lajmit të fundit, duke ftuar vit pas viti besueshmërinë e publikut. Me rastin e 15-vjetorit të televizionit, në Pallatin e Kongreseve u organizua një mbrëmje "gala" me pjesëmarrjen e të ftuarve VIP, ku pa dyshim nuk mungon edhe i gjithë stafi i kompanisë Focus Group.

MESAZHI I PRESIDENTIT TE KOMPANISË

Në fjalimin që mbajti para 1500 të pranishmëve në Pallatin e Kongreseve në 15 vjetorin e "News 24", Irfan Hysenbelliu, Presidentit të Focus Media Group e quajti këtë televizion një investim për shoqërinë duke e njehsuar me zërin e të pafuqishmëve.

"I nderuar zoti President, i nderuar zoti Kryetar i parlamentit, i nderuar Kryetar i parlamentit të Maqedonisë dhe të nderuar miq

"Dhjetëra gazetarë, spiker, drejtues emisionesh, punonjës të shkëlqyer kanë mirënjohjen time pa kufi. Urime të gjithëve!"

nga vendet fqinje! Të nderuar përfaqësues të trupit diplomatik, përfaqësues të komuniteteve fetare,

Është nder i veçantë t'ju mirëpres të gjithëve në këtë 15-vjetor për të festuar një moment të rëndësishëm për "News24". Është kaq e mrekullueshme të jesh në praninë e personaliteteve të tilla. Ky përvjetor është i veçantë për mua. Është frymëzuese kjo histori e shkurtër, është model i suksesit, historia e një investimi modest, prej disa njerëzve vizionarë. Është e veçantë, sepse mishëron pasionin, përpjekjet e qindra djemve e vajzave që i dhanë shpirtin kësaj risie që do mbërthente shqiptarët para ekranit dhe do bëhej modeli për shumë media të tjera. Pas eksperiencës së fëmijës tim të parë mediatic, gazeta "Panorama" një tjetër histori suksesi. Iu bashkova këtij projekti të veçantë me vendosmërinë për të arritur, një impakt. "News 24" nuk është biznes, por investim për shoqërinë, zëri i të

pafuqishmit. Ky është impakti që kisha ëndërruar, por "News 24" u ngrit mbi këtë filozofi", - tha Hysenbelliu.

Ai theksoi se "Në këto vite ia kemi dalë ta rrisim për ta bërë më modern, më të pavarur dhe të paanshëm, historia frymëzuese e këtyre viteve është modeli i së ardhmes. Një televizion që i shërben më shumë shqiptarëve. Dhjetëra gazetarë, spikerë, drejtues emisionesh, punonjës të shkëlqyer që kanë mirënjohjen time pa kufi. Urime të gjithëve në këtë festë të mrekullueshme!", deklaroi presidenti Hysenbelliu.

Në festën e "News 24" ishin të pranishëm personalitetet më të larta shtetërore, që nga Presidenti Ilir Meta, Kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi, ministra dhe politikanë të tjerë nga të gjitha kahet. Në pamundësi për të qenë në festë, kryeministri Edi Rama përshëndeti të pranishmit me një mesazh video.





MESAZHI

Edi Rama nuk i mungon festës së "News 24":
Një dritare informacioni, që nuk bëhet palë!

Kryeministri Edi Rama nuk i ka munguar festës së 15-vjetorit të "News 24". Ndonëse jo i pranishëm fizikisht, ai ka qenë aty për të dhënë një urim nëpërmjet një video-mesazhi. Ai tha se "News 24" është një dritare e informacionit dhe debatit. "Në pamundësi për të qenë fizikisht në festën e ditëlindjes së "News 24", dëshiroj të shpreh një vlerësim të singertë për rrugëtimin e këtij televizioni. Deri më sot, është si një dritare informacioni, si një dritare debati, si një dritare ku pavarësisht se mund t'i shquash edhe ato tipare karakteristike të mediave në tërësi dhe pragmatikave të tyre, nuk ndjek një axhendë të parashkruar për t'u bërë palë me dikë apo të dikujt, apo për të nxjerrë përfitime të drejtpërdrejta përmes keqpërdorimit të informacionit, të lajmit, axhendës dhe debatit. "News 24" është i mbarë dhe i uroj rrugë të gjatë dhe 15-vjetor të lumtur!", -tha Rama.



GAZETARJA E NJOHUR
15-vjetori, rrefehet Eni Vasili:
Si më ktheu "News24" në Shqipëri

E para, që startoi mbrëmjen gala në Pallatin e Kongreseve me rastin e 15-vjetorit të krijimit të "News24", ishte moderatorja e emisionit "Studio e hapur", Eni Vasili. Teksa uroi të pranishmit për prezencën e tyre, Vasili tregoi se si nisi rrugëtimi i saj në "News24" me emisionin e saj që transmetohet prej disa vitesh.

Vasili pohoi se ishte "News24" që e ktheu atë sërish në Shqipëri. "Mirëmbërëna, dhe faleminderit që keni ardhur! Pak vite më parë kur mora ftesën për të realizuar emisionin "Studio e hapur", isha duke bërë studimet e mia master. "News24" më ktheu në Shqipëri, dhe më vendosi në dilemë që të kthehesha në vendin tim apo jo. "News24" është me një potencial dhe jam shumë e lumtur që jam pjesë e këtij stafi njerëzish. Historinë e bëjnë njerëzit me përkushtimin dhe sakrificën", -tha Vasili.



PERVJETORI
20 vjet "Koha për t'u zgjuar", Bashkim Hoxha: Dëgjojmë zërin e qytetarëve

TIRANE - Me rastin e 15 vjetorit të themelimit të televizionit "News 24", është mbajtur një ceremoni në Pallatin e Kongreseve, me rreth 1500 të ftuar. Por kjo ditë është e veçantë, pasi edhe emisioni "Koha për t'u zgjuar" feston 20-vjetorin e krijimit. Gjatë fjalës së tij, drejtuesi i emisionit Bashkim Hoxha tha se emisioni lindi si nevojë për të dëgjuar zërin e qytetarëve.

20 vjet më parë ishte viti 1997 dhe të gjithë e kujtojmë atë vit të mbrapshtë. Ishte viti 21 mars 1997 kur ne pritëm telefonatat e para përmes emisionit "Koha për t'u zgjuar", në televizionin Teuta. Emisioni lindi si nevojë për të dëgjuar zërin e qytetarëve. 10 vjet në televizionin Teuta, ndërsa emisioni u rrit me tej në një ekran që ishte lideri i informimit ndaj publikut, pikërisht "News24".

Ndjem mirë që edhe pas 20 vitesh qytetarët na besojnë hallet e tyre. Sekret i suksesit të emisionit është se gazetaria nuk është profesion, por mision. Dua të shpreh mirënjohjen për hapësirën që ka ky emision dhe mirënjohje për zotin Irfan Hysenbleliu për mundësinë", -tha Bashkim Hoxha.



Specialistët ndërkombëtarë: Të bëhet miratimi mbi baza shkencore, jo mbi opinione

Lista e rimbursimit të barnave ende nuk ka hyrë në fuqi

Ja 30 medikamentet me rimbursim për 2017

Edhe pse në 1 maj të këtij viti duhet të hynte në fuqi lista e barnave të rimbursuara për 2017-ën, ende po përdoret lista e 2016-ës. Këshilli Administrativ i Fondit bëri me dije se në këtë listë do të shtoheshin 30 medikamente të reja, prej të cilave do të përfitonin një kategori pacientësh. Fokusi i zgjerimit të listës së rimbursimit këtë vit ishte pikërisht tek sëmundjet me përhapje të gjerë në popullatë, sikurse janë sëmundjet e zemrës dhe veshkave. Një vëmendje e veçantë iu kushtua të sëmurëve me tumor, për të cilët u shtuan në listën e rimbursimit barna që shkurtojnë kohën e hospitalizimit të tyre.

Lista e re e barnave me rimbursim mbulon edhe një kategori shumë të ndjeshme, por pak të përfaqësuar në listë, sikurse është ajo e fëmijëve. Konkretisht ishte miratuar që në listë të shtoheshin dy barna anti-diabetike, një bar kundër obezitetit, gjashtë barna për kardiologjinë që çojnë trajtimin e pacientit nga monoterapia në kombinime të ndryshme, si dhe katër barna për shërbimin e nefrologjisë. Në listë u përfshin edhe tre barna për onkologjinë si dhe tre barna në doza të ndryshme për shërbimin e Psikiatrisë. Ndërkohë që u rishikuan dhe u pasuruan me ekzaminime edhe një sërë paketash si ajo e dializës e transplantit të veshkës, implantit koklear si dhe paketat e kardiokirurgjisë, por që nuk u bënë asnjëherë të prekshme për pacientët. Specialistët ndërkombëtarë sugjerojnë që kjo listë të hartohet dhe të miratohet nga ekspertët në baza shkencore dhe jo në bazë të opinioneve për medikamente të caktuara. Në vendin tonë mungon bërja e një analize në vazhdimësi për një bar që është shtuar në listë sa i përket efikasitetit ose rezultateve të dhëna tek pacientët e si rrjedhojë, edhe mbajtja e përgjegjësisë dhe mbajtja e shpenzuara për blerjen e këtij medikamenti. Nëse bëjmë një krahasim të shpenzimeve financiare që ka bërë Fondi nga viti 2012-2016 do të vëmë re se ato kanë ardhur në rritje, por me një vlerë të vogël. Kështu respektivisht ndër vite kemi: në 2012 janë shpenzuar 7.8 milionë lekë, në 2013 - 8.4 milionë, në 2014



Foto ilustruese

- 8.3 milionë, në 2015 - 8.7 milionë dhe në 2016 janë shpenzuar 8.77 milionë lekë për rimbursimin e medikamenteve. Në projektet e saj,

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale parashikon që në listën e barnave të rimbursuara për 2018-ën të përfshijë paketën

e radioterapisë falas ose të trajtimit me rreze që do t'u bëhet pacientëve edhe në spitalet private, si dhe 5 barna të reja për trajtimin e

kancerit të gjirit. Vendimi për zgjerimin e listës së barnave të rimbursueshme u mor në mbledhjen e Këshillit Administrativ të Fondit

dhe duhet të hynte në fuqi më 1 maj 2017, por aktualisht ende po punohet me listën e barnave të rimbursueshme të vitit 2016.

ANALIZA

Në vendin tonë mungon bërja e një analize në vazhdimësi për një bar, që është shtuar në listë sa i përket efikasitetit ose rezultateve të dhëna te pacientët e si rrjedhojë edhe mbajtja e përgjegjësisë për shumata e shpenzuara për blerjen e këtij medikamenti.

LISTA E RE 2017 DO TË PËRFSHIJË BARNA:

- Antidiabetikë
- Kundër obezitetit në pacientët që vuajnë nga diabeti dhe sëmundje kardiologjike.
- Për shërbimin e Pediatrisë për Mukopolisakaridozë tipi VI.
- Për Kardiologjinë, të cilat e çojnë trajtimin e pacientit nga monoterapia në kombinime të terapevite të ndryshme.
- Për shërbimin e Nefrologjisë.
- Për shërbimin e Psikiatrisë.
- Për Sklerozën e shumëfishtë recidive remitente.
- Për shërbimin e Reumatologjisë/Dermatologjisë për sëmundjen e psoriasisit.
- Për Onkologjinë, me rëndësi për pacientët që vuajnë nga sëmundje tumorale, të cilat shkurtojnë kohën e hospitalizimit.

Veliaj: Kemi "boom" turistik, por duhet më shumë

Tirana tradicionale & moderne, pjesë e një prej panairëve më të mëdha në Europë

Për pesë javë rresht, Tirana do të prezantohet me pavionin e saj në Panairin e Brukselit, një nga më të mëdhenjtë në Europë dhe që vizitohet çdo vit nga më shumë se 2 milionë vizitorë nga e gjithë bota. Lajmin e ka dhënë kryebashkiaku Erion Veliaj përmes një postimi në "Twitter", i cili shprehet besimplotë se numri i turistëve që do të vizitohet Tiranën do të jetë edhe më i madh në vijim. "Jemi gati! Tirana tradicionale & moderne do të përfaqësohet në Panairin e Brukselit këtë fundvit. Kemi 'boom' turistik, por më shumë duhet", shkruan Veliaj. Me ftesë të Bashkisë së Brukselit, Bashkia e Tiranës do të jetë pjesë në një nga panairët më të mëdha të dimrit, i quajtur "Winter Wonder", që do të mbahet në datat 24 nëntor deri më 31 dhjetor, ku falë vizitorëve të shumtë si edhe reklamimit që i bëhet eventit në mediat ndërkombëtare, është një mundësi e mirë për promovimin kulturor, historik, social, ekonomik dhe turistik.



Kryebashkiaku Erion Veliaj

si e mirë për promovimin kulturor, historik, social, ekonomik dhe turistik. Në këtë aktivitet, Shqipëria do të përfaqësohet me një seri aktivitete si Konferenca Ndërkombëtare "Tiranë -

Bruksel, rrugëtimi historik i shqiptarëve", takimeve dypalëshë midis përfaqësuesve të biznesit shqiptar dhe atyre evropianë; vendosje të marrëdhënieve bashkëpunuese midis opera-

PANAIRI I DIMRIT
Me ftesë të Bashkisë së Brukselit, Bashkia e Tiranës do të jetë pjesë në një nga panairët më të mëdha të dimrit, i quajtur "Winter Wonder", që do të mbahet në datat 24 nëntor deri më 31 dhjetor, ku falë vizitorëve të shumtë si edhe reklamimit që i bëhet eventit në mediat ndërkombëtare, është një mundësi e mirë për promovimin kulturor, historik, social, ekonomik dhe turistik.

tradicionale shqiptare si, produkte artizanale, produkte tipike të kuzhinës shqiptare dhe produkte të ndryshme turistike etj. Gjithnjë e më shumë vëmendja e pushuesve nga e gjithë bota është tërhequr me kuriozitet drejt destinacionit më të ri turistik, Tiranës. Me një kombinim magjik të tradicionales dhe të modernes, kryeqyteti shqiptar ka potencialin për t'u shndërruar në një prej vendeve më të kërkuara nga turistët, duke ofruar një larmishmëri vendesh tërheqëse dhe infrastrukturë më të mirë. Për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një sërë nismash që synojnë rikonstruksionin e godinave që përmbajnë vlera historike apo rivitalizimin e hapësirave që ishin lënë në harresë dhe në degradim nga vitet, të cilat tashmë ofrojnë mundësi të panumërta për aktivitete në çdo orë të ditës.

torëve turistikë shqiptarë dhe evropiane, si dhe një seri eventesh dhe programesh artistike-kulturore si dhe do të ketë hapësirën e saj në qendër të Brukselit për të promovuar produktet

Zgjedhjet në Kosovë, ja komunat e mëdha që janë në balotazh

KQZ publikon rezultatet e votimit

Egla Xhemali

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka publikuar rezultatet e para të zgjedhjeve lokale, të mbajtura ditën e diel në Kosovë. Në bazë të këtyre rezultateve të publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së, rezultoni se në shumicën e komunave më të mëdha kandidatët për kryetarë të komunave do të shkojnë në balotazh.

"Koha.net" sjell rezultatet në të gjitha komunat pas orës 1:00 pas mesnate, ku pasqyra është kjo:

Në Deçan, Bashkim Ramosaj i AAK-së fiton pa balotazh me 63.18 për qind.

Në Gjakovë, pas numërimit të 90 për qind të votave, do të ketë balotazh mes të Ardian Gjinit të AAK-së dhe Mimoza Kusari-Lilës të Alternativës. Gjini ka 40.36 për qind të votave, ndërsa Kusari-Lila 31.82 për qind të votave.

Në Drenas pa balotazh ka fituar Ramiz Lladrovci i PDK-së.

Në Gjiilan janë numëruar 74.42 për qind të votave. Ky rezultat e vendos Lutfi Hazirin e LDK-së të parin me 43.56 për qind, ndërsa në balotazh hyn Sami Kurteshi i Vetëvendosjes me 26.86 për qind.

Në Dragash janë numëruar 84.75 për qind e votave e atje do të ballafaqohen Selim Kryeziu i LDK-së (37.94 %) me Shaban Shabanin e PDK-së (28.12%).

Për herë të parë Istogu shkon në balotazh. Nga 87.3 për qind e votave të numëruara, Haki Rugova i LDK-së është ndalur në 43.85 për qind të votave, i ndjekur nga Gani Dreshaj i AAK-së me 37.07 për qind.

Në Kaçanik janë numëruar 82.98 për qind e votave. Aty po zhvillohet garë e ngushtë për vendin e dytë. I pari është Besim Ilazi i PDK-së (39.21%), i dyti Basri Kodra i VV-së (21.69%) e Shkëlqim Jakupi i LDK-së me 19.59 për qind.

Në Klinë kryetari aktual Sokol Bashota i PDK-së do të duhet që edhe për katër javët e ardhshme t'i bindë qytetarët se meriton edhe një mandat. Ai ka marrë 37.48 për qind të votave, ndërsa për balotazh luftojnë Zenun Elezaj i AAK-së me 24.54 për qind të votave dhe Besim Hoti i LDK-së me 24.11 për qind. Në këtë KQZ ka numëruar 83.87 për qind të votave.

Në Fushë-Kosovë nuk do të ketë balotazh, pasi Burim Berisha i LDK-së ka fituar mandatin e katërt si kryetar komune me 63.45 për qind kur KQZ ka numëruar 82.22 për qind të votave.



Për herë të parë, VV prin në Kamenicë. Qëndron Kasratri ka fituar 34.28 për qind të votave dhe në balotazh e pret Shaip Surdullin e LDK-së që ka 28.39 për qind të votave. KQZ nga kjo komunë ka numëruar 89.29 për qind të votave.

96 për qind të votave janë numëruar në Mitrovicë. Valdete Idrizi e PDK-së prin ngushtë para Agim Bahtirit të AKR-së. E para ka 29.7 për qind e i dyti 27.13 për qind.

As në Lipjan s'do të ketë balotazh. KQZ ka numëruar 92.68 për qind të votave dhe fitues është Imri Ahmeti i LDK-së me 59.53 për

qind të votave.

94.29 për qind të votave janë numëruar në Obiliq. Kryetari aktual Xhafer Gashi i AAK-së është fare pranë kuotës së 50 përqindëshit (49.18%). Nëse Obiliqi shkon në balotazh, do t'i duhet të garojë kundër Mehmet Krasniqit të LDK-së (27.78%).

Në Rahovec prin Smajl Latifi i AAK-së (33.26%) i ndjekur nga Idriz Vehapi i PDK-së (29.68%). Janë numëruar 97.44 për qind të votave.

Ajo që pak kush e ka pritur ka ndodhur në Pejë. Gazmend Muhaxheri i LDK-

së ka fituar pa balotazh me 50.31 për qind.

Podujeva për herë të parë hyn në balotazh nëse vazhdon rezultati sikur i 88.29 për qind të votave të numëruara. Agim Veliu i LDK-së prin me 48.42 për qind, i ndjekur nga Agim Potera i VV-së me 29.84 për qind.

KQZ ka numëruar vetëm 76.69 për qind të votave në kryeqytet, Prishtinë. Sipas tyre, Shpend Ahmeti i VV-së prin me 44.52 për qind, ndërsa në balotazh do të përballen Arban Abrashin e LDK-së (35.89%).

Në Prizren janë numëruar 85.84 për qind e votave.

SIPAS KQZ-SË, NË BALOTAZH SHKOJNË:

- **Në Prishtinë:** Shpend Ahmeti nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Arban Abrashi nga Lidhja Demokratike e Kosovës.
- **Në Prizren:** Shaqir Totaj nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Mytsher Haskukanga Lëvizjes Vetëvendosje.
- **Në Gjiilan:** Lutfi Haziri nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Sami Kurteshi nga Lëvizja Vetëvendosje.
- **Në Ferizaj:** Agim Aliu nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Muharrem Sfarqa nga Lidhja Demokratike e Kosovës.
- **Në Mitrovicën jugore:** Valdete Idrizi nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Agim Bahtiri nga Aleanca Kosova e Re.
- **Në Gjakovë:** Mimoza Kusari Lila nga Alternativa dhe Ardian Gjini nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.
- **Në Pejë** pritet që Gazmend Muhaxhiri nga Lidhja Demokratike e Kosovës të konfirmohet si fitues pa balotazh, por mbetet të pritet rezultati përfundimtar.
- Për shkak të problemeve teknike, faqja zyrtare e KQZ-së ka qenë jashtë funksionit për më gjatë se tri orë dhe është funksionalizuar para mesnatës.

Shaqir Totaj i PDK-së është i pari me 30.04, ndërsa në balotazh hyn Mytsher Haskuka i VV-së me 21.92 për qind.

Siç pritej, në Skenderaj kandidati i pavarur Bekim Jashari ka fituar pa balotazh mbi 85 për qind të votave.

Në Shtime do të ketë balotazh mes Naim Ismajlit të PDK-së dhe kandidatit të pavarur Fatmir Rashiti.

LDK-ja që udhëhiqte me Suharekën tani do të hyjë në balotazh si e dyta. Sali Asllanaj i LDK-së do të garojë në balotazh me Bali Muharremajn e AAK-së.

Në Ferizaj, Agim Aliu i PDK-së po udhëheq me rreth 39 për qind të votave, duke lënë prapa Muharrem Sfarqen e LDK-së me të cilin do të përballen në balotazh.

Në Vushtrri me 80 për qind të votave të numëruara, Ferit Idrizi i PDK-së ka 32.82 për qind të votave ndërsa LDK e VV përballen fort për pozitën e dytë. Xhafer Tahiri i LDK-së ka 26.06 për qind të votave, ndërsa Besim Muzaqi ka 25.29 për qind të votave.

Malisheva është komuna e vetme në të cilën në balotazh hyn Nisma. Nisma që udhëheq me këtë komunë në balotazh hyn si e para me Ragip Begajn që ka marrë 39.97 për qind të votave. Ai ndiqet nga kandidati i PDK-së që ka 27.72 për qind të votave.

Vitia është komuna e radhës, e cila nuk do të ketë balotazh. Sokol Haliti i LDK-së ka fituar shumicën e nevojshme për t'u shmanjur balotazhit.

Thaçi, procesi përmbushi të gjitha standardet evropiane



Kosova zhvilloi ditën e diel zgjedhjet lokale, ndërsa presidenti Hashim Thaçi ka përgëzuar qytetarët për kulturën e lartë demokratike që kanë treguar në mbajtjen e zgjedhjeve lokale.

"Mbarëvajtja e zgjedhjeve të sotme ishte një sukses i radhës në forcimin e demokracisë dhe shtetit tonë. Përgëzoj të gjithë qytetarët e Kosovës që treguan kulturë të lartë demokratike, organizatorët, partitë politike, monitoruesit dhe mediat që ishin të palodhshëm për të siguruar një proces zgjedhor, që përmbushi të gjitha standardet evropiane", shkruan Presidenti i Kosovës.

Gazetari: "Dush i ftohtë", Vuçiç fituesi më i madh i zgjedhjeve në Kosovë

Gazetari Adriatik Kelmendi e ka quajtur "dush të ftohtë", faktin që Lista Serbe fitoi pa balotazh në 9 nga 10 komunat me shumicë serbe. Sipas tij, fituesi më i

madh i këtyre zgjedhjeve është Aleksandar Vuçiç. "Dhe 'dushi i ftohtë' për në fund: Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, është fituesi më i madh i zgjedhjeve në Kosovë. Lis-

ta Srpska e menaxhuar prej tij ka fituar pa balotazh plot 9 komuna dhe në Kllokot udhëheq me rreth 47%. 'Fuqi absolute në 10 komuna të Kosovës!', ka thënë Kelmendi.



LEJET E LEGALIZIMIT LISTA

Dosja për marrjen e tapisë dorëzohet nga Agjencia e Legalizimeve në Hipotekë

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 1000 persona na që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë lejet e legalizimit. Përfuttesit janë në qarkun Tiranë në zonën e Kamzës dhe Vorë. Drejtorja e ALUIZNI-t njofton qytetarët se duhet të paraqiten pranë zyrate të ALUIZNI-t në Kamzë dhe Vorë për të tërhequr lejen ndërmore. Ndërkohë që procedurat për marrjen e tapisë do të ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë. Kjo drejtori në një kohë rekord ka mbyllur të gjithë procesin për 1000 dosjet, të cilat tani kanë gati lejet dhe për pak ditë marrin certifikatën e pronësisë. Menjëherë pas regjistrimit të certifikatës së pronësisë, përfuttesit do të njoftohen

Legalizimet, 1200 personat që kanë gati lejet e legalizimit

ALUIZNI: Ja kush përfiton në Kamzë dhe Vorë

për tërheqjen e saj. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërko-

hë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalam i e së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë,

të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shtohen poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin,

nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë

takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të deponituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

1200 PERSONAT QË KANË GATI LEJET E LEGALIZIMIT

EMRI	ATESIA	MBIEMRI	GJONAJ	SHKELQIM	PETRIT	HOXHA	GEZIM	NEBI	SPAHIU	ZENEL	SHAQIR	SAVA	SHAHINI
ERMIR	SELMAN	TAPA	NAIM MISIM	ELIONAFRIM	KOLAVERI	ILIR XHEALL	SERVETE, IZET	BAJRAM	BAJRAM	RAMIZ	DEMIR	TOSHI	NUREDIN
PERPARIM	BAJRAM	MECI	SELMISALI	CERPJA	ILIR XHEALL	DOCI	KAPLLAN, JASHAR, JASHAR, JASHAR	MURATI	HAFERR	BAJRAM	ELES	NDREKA	MIRUSH
ALVINIBRAHIM	HIDA	SELIMAJ	SELMISALI	CERPJA	ILIR XHEALL	DOCI	MURATI	HAFERR	BAJRAM	ELES	NDREKA	MIRUSH	MIFTAR
XHEAL	RASIM	GJORGJI	ERTI SABA	MEMOCI	DOCI	LALA	MURATI	HAFERR	BAJRAM	ELES	NDREKA	MIRUSH	BITRI
AGRON	XHAFER	AGRON	EREMIL	AJET	DACI	MJESHTRI	HAJREDIN	NECI	HASAN	REXHEP	KUQI	VEBI	ALI
ISMAIL	SADIK	CORJA	ZEMI RUSTEM	VESEL	MUSA	BUCI	RAMIZ	HAXHI	QUNI	BEJAN	HASHAN	DOCI	KURAJ
ARJAN	ALEKSANDER	QORJA	GERSI RUFAT	TUSHA	FADIL BAJRAM	NELI	IDRIZ MAHMUT	RIZVANI	QUNI	BEJAN	HASHAN	DOCI	HAXHIU
QORJA	QERIM	VATA	BESNIK	AVDI	TOTA	QOKAJ	QAMIL	MISIM	QUNI	BEJAN	HASHAN	DOCI	HAXHIU
HALIM	SEID	KRASNQI	MAMUTDI	BASHKIM	RRAPI	SHPENDI	QAMIL	MISIM	QUNI	BEJAN	HASHAN	DOCI	HAXHIU
NAIM VEJSEL	HASI	MUCA	PETRIT	HAMDI	KOVACI	SHPENDI	QAMIL	MISIM	QUNI	BEJAN	HASHAN	DOCI	HAXHIU
HYSNI	SEID	MUCA	AVDYURIM	NEZIR	AVDYURIM	VOJA	SAMI REPAT	QAZIM	ISLAMAJ	FLAMUR	ALI	LAME	MULKURTI
RREMZI	XHAVIT	HASI	CAJKA	ISMAIL	GJONI	MYRTJA	SAHIT MEHMET	DOMI	KARA	XHEMAL	RUSTEM	AGRON	ARTIRENVER
FASLIL	ISLAM	IBRAHIM-LARI	MET	SINAN	COKA	OSMANI	SAHIT MEHMET	DOMI	KARA	XHEMAL	RUSTEM	AGRON	ARTIRENVER
KURTISH	XHEAL	BEGA	BUIJAR	TASIM	VEHAPAJ	ELZAJ	HIDAJET	FASIM	ISLAMAJ	FLAMUR	ALI	LAME	MULKURTI
BQIR, BARI	SELMAN, BQIR	QORJA	DRITAN	ISLAM	KRRASHI	KOL	FROK	PREKA	SHAHINI	ANTON	KOL	TAKA	HAXHI
GENGA	AVDULLA	PACI	ISMAIL	ISLAM	KRRASHI	KOL	FROK	PREKA	SHAHINI	ANTON	KOL	TAKA	HAXHI
ILIR MERSIN	PAZI	IBRAHIM	BUIJAR	TASIM	VEHAPAJ	ELZAJ	HIDAJET	FASIM	ISLAMAJ	FLAMUR	ALI	LAME	MULKURTI
QEMAL	MERSIN	PAZI	DRITAN	ISLAM	KRRASHI	KOL	FROK	PREKA	SHAHINI	ANTON	KOL	TAKA	HAXHI
PERIT MUSA	BUCI	JABRI	ISMAIL	ISLAM	KRRASHI	KOL	FROK	PREKA	SHAHINI	ANTON	KOL	TAKA	HAXHI
ZABIT TAPIL	GJABRI	MJESHTRI	BUIJAR	TASIM	VEHAPAJ	ELZAJ	HIDAJET	FASIM	ISLAMAJ	FLAMUR	ALI	LAME	MULKURTI
BARDHOK	ZEF	MJESHTRI	DRITAN	ISLAM	KRRASHI	KOL	FROK	PREKA	SHAHINI	ANTON	KOL	TAKA	HAXHI
HAZIZ, SULTANE	MURATDAUT	DEDA	ISMAIL	ISLAM	KRRASHI	KOL	FROK	PREKA	SHAHINI	ANTON	KOL	TAKA	HAXHI
FEMI	MEDAT, MANELLARI	BYLBYLI	ALI	DEGA	ALZEKS	FRAN	BOCI	AGIM HAN	RAMAJ	GANI	SABRI	PEPOSHI	RAMAZAN
ISMAIL	SHAQIR	KOLECI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
ARREN	AVDI	CAHANI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
LUZ	MAHMUT	MENA	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
ASLAN	MISIM	OKA	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
DILAVER	HAKIM	IMER	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
SOKOL	HILE	MEMAJ	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
MEDAT	ALI	TORBA	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
ZIADIN	BQIR	MATA	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
ISMAIL	BAJRAM	KURTI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
ISA, MUSLI	MUSLILISA	SHHEHI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
FATMIR	IMER	ALLUSHI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
RUSHIT	LUTFI	GJAFI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
HALIT	MAHMUT	MEMAJ	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
SABA	RAM	KAMERI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
ISA	ALUSH	HAJDINAJ	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
FATOS	AZZ	SARACI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
GAFUR	SULEJMAN	MELANI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
HALLI	SALI	GJOSHI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
HYSEN	HAXHI	SINANI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
LAVDIJE	MET	KOLDASHI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
GZIM	MIRUSH	CEKICI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
ASTRIT	GANI	DAFKU	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
RUSTEM	PLUMB	LLAN,	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
MYFTAR	HYSEN	HOXHAJ	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
FTTIM	RAM	LALA	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
MEHMET	MALIQ	KASEMI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
JASIM	ABAZ	SHAMCU	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
BASHKIM	BEJDIJLLA	BALLIU	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
AVNI	NAME	HALLAJ	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
HALLI	XHEM	DAMALLAJ	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
HAGHIBAJRAM	GJASHI	XHETAN	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
ISUF	XHETAN	DAZI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
PETRIT	BAFT	FARRICI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
LIJAN	SABRI	HOXHA	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
BAJRAM	ABAZ	SHAMCU	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
BASHKIM	RAMAZAN	MURATI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
AVDI	IBISH	CAHANI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
QAZIM	HALIM	LALA	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
TUKURJUE	TAHIR	TROCI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
NAIM	ISMAIL, DAUTI	NAIM, HAZRIJE	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
IBRAHIM	CARA	KORBI	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
ISMAIL	MEHDI	HIDA	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
TIXHE	DAUT	DEDE	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN
ASTRIT	_DONAT	ZEF DEDE	ISMAIL	ISHUF	DODA	CAHANI	MENA	RUZZIJE	HYSEN	PERGJINI	BILAL	MURAT, XHAKOLA	ASLAN

Table with 10 columns of names and surnames, listing individuals in a grid format. The names are arranged in rows and columns, representing a directory or list of people.

VIZITA

“Rindërtimi i krimit”, vepra e artistes serbe për vrasjen e shqiptarëve

Fatmira Nikolli

Linja muzeale e Muzeut të Artit Bashkëkohor në Beograd ka të ekspozuar një veper që në mënyrë të tërthortë shënon një “ndjesë” ndaj shqiptarëve dhe pranon vuajtjet e tyre nën ish-Jugosllavinë.

Vepra i takon artistes Milica Tomic, pjesëmarrëse në Muzeun e Artit Bashkëkohor me punën e titulluar “XY the reconstruction of the crime”.

Tema e kësaj pune, realizuar në vitet 1996/1997 është krimi i harresës absolute të vrasjes së demonstruesve, shqiptarëve etnikë, qytetarë të Republikës Federale të Jugosllavisë.

“XY the reconstruction of the crime 1996/97” - është një veper që ka si temë, krimin e harresës absolute të vrasjes së demonstruesve, shqiptarëve etnikë, qytetarë të Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë. Vepra, një video instalacion 13-minutësh është e artistes serbe Milica Tomic. Vetë sqarimi i sapocituar është marrë nga shënimi i kuratorit Branimir Stojanovic. Po aty, shënohet se “më 28 mars 1989, ata protestuan kundër shuarjes së subjektivitetit politik të garantuar nga kushtetuta federale ekzistuese. Puna merret me pamundësinë e zgjidhjes së konfrontimit të minoritetit dhe shumicës. Me fjalë të tjera - kontradiktat e brendshme të komuniteteve bazuar në ekonominë e sakrificës.

Kuratori Branimir Stojanovic shkruan se “XY the reconstruction of the crime” në medimet e artit bashkëkohor zbulon fillimin e përkallëzimit të dhunës së pakontrolluar në RSFJ në fund të viteve '80, e cila përfundoi me një copëz të errët dhe kanibalizëm etnik.

TAKIMI I KUMBAROS

Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro Furxhi mori pjesë në ceremoninë e hapjes së Muzeut të Artit Bashkëkohor në Beograd, ku është ekspozuar vepra e mësipërme, me ftesë të ministrit të Kulturës dhe Informimit të Republikës së Serbisë, Vladan Vukosavljević. Ajo u prit nga drejtori i Muzeut të Artit Bashkëkohor, Slobodan Nakarada dhe Dejan Sretenović, koncept ideuesi i MAB, të cilët e shoqëruar përgjatë vizitës në MAB. Ministria Kumbaro zhvilloi takime me homologun serb dhe atë maqedonas, Robert Alogjovskij, ku u diskutua për një bashkëpunim intensiv me vendet e rajonit në fushën e artit dhe kulturës, thuhet në një njoftim për mediat që zyra e shtypit të MK u ka nisur gazetarëve. Po sipas të njëjtit njoftim, ministri Vukosavljević ka theksuar se kultura po lidh dhe po lejon njerëzit të kuptohen më mirë dhe ata, artistët, përfaqësojnë “një melodi që dëgjohe



Kumbaro gjatë vizitës në Beograd

Kumbaro në Beograd: Arti dhe kultura, hapësira që ndërtojnë ura bashkëpunimi

mbi zhurmën e jetës së përditshme”. Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro u tha agjencisë së lajmeve ‘Tanjug’ se Muzeu i Artit Bashkëkohor “nuk është vetëm një muze i ri, apo një muze i rinovuar, por një vend pa kufij. Arti dhe kultura janë hapësira që duhet të ndërtojnë ura, pavarësisht nga vendi apo ngjyra e pasaportës”, - u shpreh Kumbaro. Ajo shtoi se është veçanërisht e impresionuar me vendosjen e veprave, që reflekton idenë e bashkimit të artistëve nga vende të ndryshme të Ballkanit. “Para së gjithash, është e rëndësishme që ky vend, i cili u mbyll për dhjetë vjet, tashmë është i hapur për publikun. Ne jemi vende të vogla dhe nuk kemi luksin që të mbajmë hapësira të mbyllura. Mendoj se ky është një sukses i madh për Ministrinë e Kulturës dhe për të gjithë artistët. Së dyti, unë jam e impresionuar me të vërtetë nga pjesëmarrja e artistëve dhe e vlerësor faktin që artistët këtu janë bashkuar nga territore të ndryshme të Ballkanit”, - tha Mirela Kumbaro Furxhi për “SEcult”, e përditshme e pavarur kulturore në Beograd. “Ky vizion për të bashkuar punën e artistëve nga e gjithë ish-Jugosllavia është një ide shumë e bukur; jo vetëm për artistët, por edhe për shkak të historisë së përbashkët të rajonit tonë”, ka thënë Kumbaro, duke theksuar rëndësinë e dialogut përmes arteve. Gjatë vizitës së saj, Kumbaro deklaroi se tani është një

çështje e vullnetit politik për të ndërtuar ura dhe institucionet artistike të krijojnë bashkëpunime konkrete. Si shembull, ajo tregoi bashkëpunimin e mundshëm ndërmjet Galerisë Kombëtare në Tiranë dhe MAB të sapohapur në Beograd, si dhe bashkëpunimet mes teatrit të dramës, baletit, orkestrave, etj. Gjatë qëndrimit në Beograd, ministria Mirela Kumbaro Furxhi zhvilloi një vizitë në Teatrin Kombëtar të Beogradit. Në një bisedë të hapur me drejtorin Dejan Savić u diskutuan për mundësitë e bashkëpunimit dhe programeve kulturore të shkëmbimit dhe projektet mes institucioneve kulturore kombëtare. Kumbaro u prit nga zëvendësdirjtor i Teatrit Aleksander Stamatović, drejtor i bashkëpunimeve Samur Ranković dhe drejtori i Operës, Janko Sinadinović. Gjatë vizitës, të fuqiar vizituan ndërtesën, muzeun dhe teatrin, ku u njohën me një histori shumë të pasur dhe repertorin e Teatrit Kombëtar, si dhe funksionimin e institucioneve të rëndësishme serbe kulturore, (Teatër, Opera, Balet), të cilat së shpejti do të festojnë 150-vjetorin.

Ministria e Kulturës së Shqipërisë në përfundim të Konferencës së tretë Ministeriale në Tiranë, shkurt 2017 “Nxitja e Kulturës për Zhvillim të Qëndrueshëm” ka firmosur marrëveshjen e parë për bashkëpunim kulturor me Serbinë,



XY the reconstruction of the crime

The theme of this work is about the crime of absolute forgetting of the killing of the demonstrators, ethnic Albanians, citizens of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia. On March 28th 1989 they protested against the abolishment of the political subjectivity guaranteed to them by the existing Federal constitution. The work deals with the impossibility of solving the confrontation of the minority and the majority apartheid. In other words – the inner contradictions of the communities based on the economy of sacrifice. XY unveils in the media of contemporary art detects the beginning of the escalation of the uncontrolled violence in SFRJ in the end of the '80s, which ended in a dark dismemberment and ethnic cleansing.

Branimir Stojanovic

Vepra e Milica Tomic

“RINDËRTIMI I KRIMIT”

Vepra i takon artistes Milica Tomic, pjesëmarrëse në Muzeun e Artit Bashkëkohor me punën e titulluar “XY the reconstruction of the crime”.

Tema e kësaj pune, realizuar në vitet 1996/1997 është krimi i harresës absolute të vrasjes së demonstruesve, shqiptarëve etnikë, qytetarë të Republikës Federale të Jugosllavisë.

cilësuar nga ministri Vukosavljević si një moment historik për bashkëpunimin kulturor mes dy vendeve. Qëllimi i këtij programi bashkëpunimi kulturor është të zhvillojë dhe mbështesë bashkëpunimin kulturor mes institucioneve dhe organizatave të ndryshme të të dyja vendeve, në shkëmbimin e përvojave dhe realizimin e politikave në art-kulturë dhe trashëgimi kulturorë, në përpjekje me standardet e Bashkimit Evropian, UNESCO-s, në përpjekje për të ndërtuar dhe nxitur marrëdhënie të mira dhe për të forcuar bashkëpunimin kulturor mes palëve.

“Ftesë në rrethin e dhjetë” është roman i një ndjeshanerie të lartë qytetare. Me këtë roman Flutura Ačka bën një prerje të thellë anatomike mbi shoqërinë e sotme shqiptare, duke zbritur deri thellë në ditët e para të ngjizjes së shtetit shqiptar. Dinamika, subjektet, personazhet, teknikat e rrëfimit e të shkrimit janë thjeshtë marramendëse. Ky shënim duket si në konflikt interesi, pasi Flutura Ačka është botuesja e prozës sime në shqip, por më duhet po ashtu të theksoj se ajo dhe unë, jemi në një konkurrencë të pamëshirshme si autorë. Pasi mbarova së lexuari në dorëshkrim këtë roman, u gëzova, jo thjeshtë për atë si autore, por për letërsinë dhe shkrimin shqip, pasi pak

pikë dyshimi ky roman do të përbëjë një pikë shënjuese në letrat tona. Flutura edhe me romanet tjera, si “Ku je?”, “Kukulat nuk kanë atdhe” etj., ka vënë stekën e saj letrare në lartësi sfiduese, por me këtë roman, ajo avancoi edhe më shumë.

Romani ka në qendër tre personazhe, miq fëmijërie e që vendosin të takohen pas shumë vitesh, për të festuar një përjetor. I strukturuar në dhjetë kapituj, të thirrur “rrathë”, si reminiscencë e rrrathëve të Ferrit të Dantes, lexuesi njihet me jetën e tyre, me jetët e tyre, me të shkuarën dhe tashmen e vendit nga vijnë dhe atdheut, të cilin kanë zgjedhur për të jetuar. Përmes tyre edhe dhjetëra personazhe të tjerë hyjnë në shtjellë duke sjellë mikro-dramëzat, historitë e tyre të vogla e të mëdha. Romani përshkruan njeriun e sotëm shqiptar, por edhe atë evropian, me

EKSPOZITA

Fatmira Nikolli

ROSEMARIE TROCKEL

Nga Serpentine e Londrës në Galerinë Kombëtare

“Unë mendoj për veprën si të padukshmen e bërë të dukshme dhe nuk ka rëndësi kaç shumë për mua nëse kam bërë apo jo.”

“Rosemarie Trockel, artistja e njohur që doli nga Këlni në vitet 1980, kurrë nuk do të pajtohej me retrospektivën tradicionale të muzeve. Arti i krijuar prej saj – që shtrihet nga filmi në skulpturë e deri te sendet e jetës së përditshme - kurrë nuk ka qenë i lidhur në një vijë të vetme dhe i ka rezistuar gjithmonë përjekjeve për të gjetur unitetin në diversitetin e saj”.

The Guardian është ndalur gjatë në punët e artistes gjermane Rosemarie Trockel, në vitin 2012 dhe në vitin 2013, kur ajo do të ekspozohet në Serpentine Gallery, një prej hapësirave më të zëta të artit në Britaninë e Madhe. Atëkohë, qenë përfshirë në një ekspozitë “retrospektivë” punët e artistes dhe ndikimet e shekujve të ndryshëm që e kishin shoqëruar veprën, duke formuar me tërësinë e veprave një “hartë” të paraardhësve të saj artistikë, –siç shkruan The Guardian- një kozmos, frazë prej së cilës u “huazua” titulli i atij artikulli dhe i ekspozitës së parë të saj të madhe muzeale në SHBA mbi një dekadë më herët. Ajo ekspozitë u shfaq edhe në Reina Sofia në Madrid dhe udhëtoi më pas në Serpentine në Londër. “Arti i Trockel është enigmatik, por kjo nuk do të thotë se është i vështirë”, shkruante The Guardian, duke shtuar se ekspozita ishte një sukses i befasishtëm. Gazeta shtonte se Trockel është një artiste gjermane me influencë në të 60-at e njohur kryesisht për veprën me batanije të thurura që përfshin in logot e diskutueshme - lepurin e Playboyt a simbolin bërthamor – duke bërë art politik përmes punës së grave. “Gjeste të tilla janë të lidhura me kohën dhe ambientin e hapjes së


kësaj shfaqjeje është e stilit të viteve 70-të: një bibliotekë e pamfleteve, librave, librave të dobët, vizatimeve veprave të tjera në letër”.

ROSEMARIE TROCKEL NË TIRANË

Mbas ekspozitave të suksesshme në New York e Londër, me ekspozitën “Vizatime, Objekte dhe Video të Përzgjedhura” në datat 24 tetor - 3 dhjetor veprat e Rosemarie Trockel do të jenë në Tiranë. Futja e kryeqytetit tonë (me vonesë) në këtë hartë është megjithëkëtë jo pa rëndësi. Janë Galeria Kombëtare e Arteve dhe Ambasada Gjermane që e hapin ekspozitën “Rosemarie Trockel – Vizatime, Objekte dhe Video të Përzgjedhura”. Ekspozita e artistes së famshme gjermane Rosemarie Trockel (lindur në vitin 1952 në Schwerte, Gjermani hapet si një nga aktivitetet e rëndësishme të Tetorit Gjerman për vitin 2017. Kjo është hera e parë që kjo artiste ekspozon veprat e saj në Shqipëri.

Rosemarie Trockel vlerësohet si një nga artistet më të famshme bashkëkohore sot në shkallë globale, e cila e shpreh vështirimin e saj krejtësisht vetjak për botën me anë të objekteve, skulpturave dhe instalacioneve. Kjo ekspozitë në Galerinë Kombëtare të Arteve i mundëson publikut shqiptar për herë të parë një udhëtim eksplorues në veprat e kësaj artisteje shumëdimensionale: duke nisur nga vizatimet, fotografitë, tablotë e fam-

Ekspozita e artistes së njohur gjermane mbërrin në Shqipëri



shme me thurje e deri tek “Malmachine” dhe video-instalacionet.

Sipas GKA-së, skena artistike, e dominuar për kohë të gjatë nga meshkujt, e ka nxitur Rosemarie Trockel-in qysh herët për kundërvënien ndaj saj. Ajo vazhdimisht formulon pozicione kundërshtie dhe pasqyron pikëpamjen e saj si një përfaqësuese e botës së theksuar artistike femërore, dhe nuk kursehet as me kritika parimore ndaj sistemit ekzistues të artit. Por, pavarësisht qëndrimit të saj kritik, veprat e Rosemarie Trockel-it shfaqen për vizitorin si projekte të vrullshme mendimesh



plot fantazi dhe si skica artistike qartësisht bindëse.

Në punët e Rosemarie Trockel, në mënyrë rituale dhe të pandërprerë, mediat tradicionale dhe ato të reja shkrihen në lidhje të befasishme për shikuesin. Kjo është veçanërisht e dukshme në vizatimet me tush, karbon, laps, kolazhet apo dhe vizatimet kompjuterike, të cilat zënë një vend të rëndësishëm në veprën e saj. Çdo fazë e re e punës së Rosemarie Trockel shoqërohet me vizatime, të cilat janë dhe skica që vënë në dukje vëzhgimet dhe idetë e saj në proces krijimi, por, siç është veçanërisht e dukshme në veprat aktuale të formatit të madh, ato, gjithashtu, formojnë edhe një trup të pavarur pune dhe krijimtarije. Si rrjedhim, kjo ekspozitë vë një theks të veçantë në veprat në këtë medium, por edhe në videot e saj.



të gjithë kompleksitetin e tij, dyzimet, luhatjet, arritjet, brençat, dhimbjet, tonet e shpirtit, shpërthimet e ndjenjave e të mendimeve. Dhurata për lexuesin është e magjishme. Pakkush mbetet pa e gjetur vetveten në këtë roman, që nga ata që na drejtuan e na drejtojnë, ata që u shuan përfundimisht përmes vrasjeve e burgimeve të pashpirta, ata që mbijetuan duke u përballur apo gjunjëzuar, ata që ikën, duke mbetur me kokë të kthyer pas, ata që na pritën, na i hapën apo mbyllën dyert e shtëpive të tyre në Europë. Drama e personazheve zbulohet ngadalë, në një mbrëmje florentinase, në atdheun e Dantes. Po ashtu si dhe bota e tyre e brendshme, psikologjia shprestat, arritjet dhe dështimet e tyre.

Lexusit i bëhet edhe një dhuratë tjetër: romani përshkohet nga një pasuri e jashtëzakon-

Arbër Ahmetaj: Një roman me shkëlqim humanist

shme informacioni mbi historinë, arkitekturën, artin dhe muzikën. Flutura Aça merr përdore lexuesin përmes bukurive të qyteteve europiane, na shoqëron në artin dhe letërsinë e sotshme e të djeshme, duke dëshmuar njohje të thella të tyre për veten e vet dhe një bujari të rrallë për lexuesit e saj.

Personazhet, pavarësisht anëve të errëta e komplekse të jetës së tyre “udhëhiqen” përmes rrathëve të ferrit nga dashuria, si Virgjili i antikitetit shoqëron Danten. (Në roman janë përfshirë dhjetëra tercinat të veprës së famshme, të përkthyer në shqip nga Pashko Gjeçi, si eko të gjendjeve të ngjashme). Dashuria, kjo ndjenjë

sublime, e përndritshme e përtëritëse, jo rrallë edhe i djeg me shkëlqimin e saj tundues. Autorja ka alternuar me mjeshtri emocione të thella e të bukura, me përshkrime e qasje analitike përmes dialogësh inteligjente, duke sjellë peshën e rëndë që bartin personazhet e saj. Romani u ka shpëtuar gjithësesi toneve publicistike, pasi autorja nuk mban anë, ajo u jep hapësirën e domosdoshme gjykimeve të personazheve të veta, u jep atyre lirinë e plotë të gjykimit, liri, në kërkim të së cilës ata kanë sakrifikuar aq shumë. Gjykimi i fundit u takon lexuesve! Libri kënaq edhe etjen e gjahtarëve të shprehjeve të bukura, të citateve të



mençura, pasi personazhet e romanit, janë njerëz me përvojë e kultura të çmueshme, gjë që u jep atyre një shkëlqim humanist!

“Ftesë në rrethin e dhjetë” është po aq i mirë, sa edhe romani “Dernier des Nôtres” i Adelaide de Clairmont-Tonnerre, që ka fituar “Grand prix du roman de l’Académie Française 2016”. Ua kam rekomanduar miqve të mi frankonë këtë roman dhe nuk kanë mbetur të zhgënjyer: i nxis miqtë e mi të pasionuar pas letërsisë shqipe ta lexojnë romanin e Flutura Açkës, “Ftesë në rrethin e dhjetë”, pasi jam i bindur që do të mbeten shumë të kënaqur. Ky roman arrin të bëjë dy gjëra njëherësh, të rrëfejë në mënyrë të mrekullueshme një histori dhe të ngjallë emocione estetike, emocione që vijnë nga shkrimi i bukur, nga vetë fjala.

Opinion i Ditës

Nga Përparim KABO

(Vijon nga faqja e parë)

... ajo ngjarje u nënshtresëzua në veprime brenda Hungarisë dhe në planin ndërkombëtar në një mënyrë të tillë që, sa herë rikthehemi gjëjmë çfarë të shohim ndryshe, bindimi edhe një here tjetër pse duhet të dëgjojmë jehonat historike dhe përse është me vlerë të ballafaqohemi me fenomenet e të sotmes duke ndërtuar krahasimet e nevojshme. Me revolucionin hungarez të 1956-s filloi një nga periudhat më të tensionuara të "Luftës së Ptohtë", e cila u bashkëhoqëra aso kohë edhe me një përgjigje të jashtëzakonshme ndaj krizës së refugjatëve që pasoi, ngjarje kjo e pa taktuar më parë, e cila solli përfitime të konsiderueshme për brezat e ardhshëm të refugjatëve anembanë botës sepse krijoi precedentin dhe modelin e sjelljes.

Si dhe çfarë ndodhi në 1956-n... Tanket sovjetike u kthyen në Budapest më 4 nëntor 1956 dhe revolucionin u shtyp shpejt.

Gjatë fundjavës së 4-6 nëntorit, rreth 10,000 hungarezë hynë në Austri. Klasa të tërë nxënësis - madje edhe shkolla të tëra - filluan të kalonin kufirin e pothuaj të hapur. Studentët, mësuesit, mjekët, atletët e famshëm dhe futbollistët, fermerët, arkitektët dhe punëtorët filluan të iknin si lumë në Austri. Kjo ishte kriza e parë e madhe e refugjatëve që u shfaq në televizion, në gazeta si dhe në shfaqje dokumentarësh në kinema. Njerëzit në të gjithë botën u tronditën duke parë skena nga Budapesti dhe nga kufiri i ku terreni ishte i mbuluar me borë. Në 16 nëntor, numri i refugjatëve ishte rritur në 36,000 dhe nga fundi i nëntorit, shkoi në 113,000. Deri në kohën e mbylljes së kufijve, gjithsej 200,000 hungarezë ishin arratisur (180,000 në Austri dhe 20,000 në Jugosllavi) Brenda disa ditësh nga fillimi i eksodit, një veprim i jashtëzakonshëm ndihme u ngrit në Austri, jo vetëm për t'u kujdesur për refugjatët, por edhe për t'i larguar ata nga vendi pothuajse aq shpejt sa arritën. Në fund të procesit 180,000 u zhvendosën nga Austria dhe Jugosllavia në 37 vende të botës. Performanca e austriakëve, agjencive të ndihmës dhe vendeve të zhvendosjes ka qenë e rrallë, e pa taktuar ndonjëherë deri në atë kohë por edhe sot. "Të dy qeveritë dhe popullatat ishin të angazhuara jashtëzakonisht për të ndihmuar njerëzit që iknin nga Hungaria në atë kohë", tha në vigjilje të 60 vjetorit të kryengritjes (23 tetor 2016), komisioneri i lartë i OKB António Guterres. (António Manuel de Oliveira Guterres është një politikan dhe diplomat portugez, i cili shërben si Sekretari i Përgjithshëm i nëntë i Kombeve të Bashkuara. Më parë, ai ishte Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët midis viteve 2005 dhe 2015)

"Ishte lëvizja e parë në të cilën refugjatët u njohën në masë. Ishin 100,000 njerëz të zhvendosur në 10 javët e para - gjë që unë mendoj se është e pa konceptueshme edhe sot." Në Vjenë u krijuar menjëherë një komision i përbërë nga Ministri i Brendshëm Austriak Oskar Helmer dhe stafi i tij, nga UNHCR, Komiteti Ndërqeveritar për Migracionin Europian (CEM) dhe nga Shoqata e Lidhjes së Kryqit të Kuq (LRCS) si dhe një numër shoqatash lokale dhe OJQ-sh ndërkombëtare. U vendos që LRCS do të ishte forca kryesore lëvizëse në frontin e asistencës dhe do të ndihmonte, gjithashtu, ICEM, detyra kryesore e të cilit do të ishte të ndihmonte regjistrimin, dokumentimin dhe transportimin e refugjatëve jashtë Austrisë. UNHCR-ja do të merrej me çështjet e mbikëqyrjes ligjore dhe të mbrojtjes, si dhe me integrimin e atyre që mbetën në Austri. Zoti Helmer gjithashtu donte që UNHCR të ishte koordinatori i përgjithshëm - ose "agjencia udhëheqëse" - një rol që u konfir-

Revolucioni hungarez i 1956-s dhe kriza e refugjatëve...

mua më pas edhe nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-s. Përballë kësaj gjendjeje komplekse, UNHCR nuk se gëzonte ndonjë pozitë më të mirë për të trajtuar një detyrë të tillë. Ajo ishte vetëm një organizatë me një mandat të përkohshëm që duhej të skadoonte më 1958-n. Së dyti, ishte pa një Komisioner të Lartë. Që nga muaji korrik Gerrit van Heuven Goedhart kishte vdekur nga një atak në zemër dhe zëvendësuesi i tij, Auguste Lindt, nuk u zgjodh deri në dhjetor. Është fakt që stafi i lartë i agjencisë u dëshmuua me shumë se i aftë për të trajtuar sfidën. Pas një nisjeje kaotike, operacionet e ndihmave dhe zhvendosjes vazhduan pa probleme. Të tri agjencitë koordinuese dhe shumë OJQ që punuan me to krijuan një performancë të jashtëzakonshme. Një shembull historik humanizmi përkushtimi dhe organizimi që edhe sot në ditët tona të lë përshtypje tejet të thella. Brenda pak ditësh nga ardhja e refugjatëve të parë, u bë një përpjekje masive për rivendosjen përfundimtare të hungarezëve. Gjatë muajve në vijim, ata u transferuan me autobusë, trenat, anije dhe aeroplanë në 37 vende të ndryshme në pesë kontinente. Vende të mëdha si Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja pranuan secili prej tyre rreth 40,000 persona, ndërsa Mbretëria e Bashkuar pranoi 20,000.



Gjermania me Australinë rreth 15,000 persona secila. Dy vende afrikane dhe 12 vende të Amerikës Latine morën gjithashtu një numër të vogël hungarezësh.

Duke vështruar prapa, ndoshta aspekti më i rëndësishëm ishte pragmatizmi dhe fleksibiliteti i aktorëve kryesorë - veçanërisht ai i shteteve. Ishte operacioni i parë i ndihmës së refugjatëve të këtij lloji. Për një gjë, kishte pasiguri nëse hungarezët ishin teknikisht refugjatë sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët të vitit 1951 dhe nëse UNHCR kishte një mandat për t'u marrë me ta apo jo? UNHCR e mbështetur nga Austria, vendosi për shpërndarjen e tyre dhe shtetet pritëse ranë dakord. Neni 6B i Statutit të UNHCR-së duket qartë se e mbulonë situatën. Por, sipas përkufizimit të Konventës e vitit 1951, nuk ishin refugjatë vetëm produktet e ngjarjeve që kishin ndodhur para vitit 1951? Këshilltari kryesor ligjor i UNHCR-së, Paul Weis hartoi një argument që i plotësonte kriteret ligjore lidhur me datën e skadimit të përcaktimit të Konventës. Përveç kësaj, statuti i UNHCR-së është përdorur si bazë për të vendosur se një grup që mbërrin në masë, si hungarezët, mund të njihet 'prima facie' - një zhvillim jashtëzakonisht i rëndësishëm ky në ligjin dhe praktikën ndërkombëtare të refugjatëve. Prej këtij interpretimi kanë përfituar ndër vite dhjetëra milionë refugjatë. Kryengritja e vitit 1956 dhe pasojat e saj ndihmuuan në mënyrën se si organizatat humanitare - dhe jo më pak UNHCR - do

duhej të merreshin me krizat e refugjatëve. Ngjarjet e 1956-s me refugjatët, gjithashtu, lanë një shenjë të pashlyeshme në ligjin dhe politikën ndërkombëtare të refugjatëve. "Më kujtohet, - isha djale i ri në atë kohë, - dhe ishte aq mbresëlënëse, aq e fortë. Reagimi i bashkësisë ndërkombëtare ishte i jashtëzakonshëm", tha zoti Antonio Guterres në përvjetorin e 60-të asaj ngjarje tronditëse dhe impresionuese njëherësh. Pas Luftës së Dytë Botërore, shumë menduan se ky ishte fundi i krizave të refugjatëve." Megjithatë, ajo vazhdoi, kryengritja hungareze "tregoi se probleme të tilla do të vazhdonin të ndodhin herë pas here dhe se bashkësia ndërkombëtare do duhej të përgatitej në një mënyrë bujare dhe të hapur për t'u marrë me problemet e refugjatëve".

Shumë nga hungarezët kaluan kufijtë me ndihmën e kontrabandistëve dhe shumë njerëz arritën pa dokumente identiteti, por nuk e dëmtuan imazhin e tyre dhe nuk u paragjyquan. Nuk u pengua pranimi i tyre si refugjatë. Në një farë mënyre që nga ajo kohë pak është ndryshuar sjellja institucionale në botën e refugjatëve, përveç ndoshta fakteve të hidhura që 60 vjet më vonë bota duket shumë më pak e prirur për t'u përgjigjur me një mikpritje të tillë spontane e bujare si atëherë. Ja si shprehet zoti Guterres:

"Bashkësia ndërkombëtare u përdor kaq shumë për krizën ndërkombëtare dhe për fat të keq sot ne jemi dëshmitarë të situatave në të cilat asaj e vuajtjes është shumë më e madhe se ajo që pamë në Budapest - dhe indifferenca është gjithashtu shumë më e madhe". Ky përfundim nuk ka nevojë për koment të mëtejshëm. Pas po thuaj 60 vitesh, një ngjarje tjetër me refugjatë, por tani në një sens tjetër është duke ndodhur. Hungaria duhet të presë refugjatë. Sjellja është ndryshe. Dihet se Hungaria me një gardhë të lartë tëli e ka mbyllur kufirin dhe pranimi refugjatëve është një çështje tejet delikate si brenda vendit ashtu edhe në kuadrin e Bashkimit Europian si dhe në hapësirat e zonës Shengen.

Përsëri kriza e refugjatëve veçse ndaj tyre një sjellje ndryshe...

Kur komisioneri i lartë i OKB për refugjatët Filippo Grandi vizitoi refugjatët në kufirin hungarez i bëri thirrje Hungarisë të përmirësojë aksesin për njerëzit që kërkojnë azil dhe të hiqej dorë nga të ashtuquajturat "zonat e tranzitit" kufitar, të cilat tha ai: "Janë, në fakt, thjesht qendra të paraburgimit." Ai i bëri komentet në një konferencë shtypi në kryeqytetin hungarez pas një vizite në një nga dy zonat transit të Hungarisë, ku zyrtarët shpjeguan se vetëm rreth dhjetë kërkues të azilit në ditë pranohen në vend. "Nëse vendosni kufizime për të hyrë në territor - përdorimin e paraburgimit për azilkerkuesit dhe shkallën e ulët të njohjes, së bashku me mungesën e ndonjë investimi për të inkurajuar

integrimin e atyre që njihen si refugjatë - përshtypja ime themelore është se ka një përpjekje kufizonjëse tejet të ashpër ndaj numrit të njerëzve që lejohen për të ardhur në Hungari dhe për të kërkuar mbrojtje. Rrethatat e tilit me rrota të gardheve në Roszke përcjellin "simbolin e refuzimit", -u tha gazetarëve Filipo Grandi.

U nënvizua se: "Mbrotjtja e refugjatëve dhe siguria e vendit nuk është se janë të papajtuashme." Në takimet në Budapest, me Ministrin e Punëve të Jashtme Péter Szijártó dhe atë të Brendshme Sándor Pintér, Zoti Grandi theksoi se Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatë një të drejtë e çdo vendi për të mbrojtur kufijtë e saj. Por, tha ai: "Mbrotjtja e refugjatëve dhe siguria e vendit nuk janë të papërputhshme." Ai, gjithashtu, theksoi rëndësinë e solidaritetit europian dhe të të gjitha shteteve anëtare të BE, përfshirë edhe Hungarinë, duke marrë pjesë në programin për zhvendosjen e azilkerkuesve nga Greqia dhe Italia. Ai pasqyroi shqetësimin për fëmijët që kishte taktuar, të cilët mbahehin në "zonat e tranzitit", në pritje të një vendimi për aplikimet e tyre për azil. "Fëmijët, në veçanti, nuk duhet të kufizohen në paraburgim.", -vuri theksin Zoti Grandi. Pasi udhëtoi në zonën e tranzitit të Roksit në kufirin e Hungarisë me Serbinë gjatë një vizite dy-ditore në vendin e Europës Qendrore; Ai vuri në dukje se fëmijët më të vegjël se 14 vjeç që kishin mbërritur vetëm në Hungari transferohen në një qendër të hapur ku ata po marrin kujdes të përshtatshëm dhe inkurajojë Hungarinë të mbajë një strukturë të tillë duke e zgjeruar atë për të përfshirë fëmijët më të rritur dhe të pashoqëruar nga prindërit. "Kërkimi i azilit nuk është një krim", tha ai. "Refugjatët që takova janë thjesht në kërkim të sigurisë në Europë dhe tani i shohin veten jashtëzakonisht të shqetësuar për të ardhmen e tyre".

Ai i bëri thirrje qeverisë hungareze që të lehtësojë kufizimet në sistemin e saj të azilit në mënyrë që azilkerkuesit që hyjnë në vend të mos ballafaqohen me pengesa dhe të mund të dëgjojnë rastet e tyre në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Hungarisë. Në vizitën e tij në Roszke, Grandi takoi dy djemtë 14-vjeçarë, të cilët e gjetën rrugën e tyre për në Hungari. Ahmed, nga Aleppo e Sirisë, i tregoi se ika nga lufta në atdheun e tim kur isha vetëm 12 vjeç dhe mbërriti në Hungari pas një udhëtimi shumë tronditës. Ai i tha Grandit se ai shpresonte të merrte azil këtu, sepse familja e tij ishte në rrezik. Nëse ai merr statusin e refugjatit, ai shpreson t'i shpëtojë duke aplikuar për bashkim familjar. Grandi pa se si refugjatët jetonin në kontejnerë në nëndarje të vogla të mbyllura. Sulejmani nga Kabul, i tregoi një shenjë të madhe në krahun e tij si rezultat i një sulm talibanësh në shtëpi. Kam frikë të kthehem dhe dëshiroj të qëndroj në Hungari. Azilkerkuesit më së shumti ankohen për mungesën e informacionit rreth procesit të azilit. Hungaria ka kufizuar sistematikisht sistemin e saj të azilit përmes masave ligjore kufizuese dhe ka eliminuar pothuajse mbështetjen e shtetit për refugjatët. Kur azilkerkuesit hyjnë në një nga dy zonat tranzitore të Hungarisë, normat e njohjes së refugjatëve janë tejet të ulëta, madje edhe për njerëzit që ikin nga vende të përfshira nga konflikti si Iraku dhe Afganistani. Zyrtarët hungarezë i thanë komisionerit të lartë se po punojnë në përmirësimin e procedurave. Gjatë vizitës së tij, Grandi vizitoi, gjithashtu, Qendrën Globale të Shërbimit të UNHCR-së, ku punojnë rreth 500 anëtarë të stafit. Këto përfshijnë rreth 300 shtetas hungarezë, të cilët ofrojnë mbështetje thelbësore për anëtarët e stafit të UNHCR-it që mbrojnë refugjatët në mbarë botën. Ai i shprehu mirënjohjen e tij ndaj qeverisë hungareze për →

Opinion i Ditës

Nga Dr. Jorgji KOTE

Sinatra dhe doktrina që fundosi komunistizmin

(Vijon nga faqja e parë)

... periudhën dhe vendin e kompozimit/interpretimit, artistët elitare që e kanë performuar dhe sidomos ajo për të cilin do të ndalem në këtë shkrim - referenca me politikën e një superfuqie lindore si ish - Bashkimi Sovjetik. E kemi fjalën për superhitin muzikor " I did it my way".

Gjeografia e kësaj kënge e ka zanafillën në Angli me titullin " For me " (Për mua) Pastaj, superylli i muzikës franceze të viteve 60 - 70, Claude François me tekst të Jacques Revaux në vitin 1968 e ktheu atë në hitin e njohur "Comme d'habitude" (Si zakonisht) Jehona e saj i kapërceu shpejt kufijtë e Francës dhe mbërriti në SHBA.

"Comme d'habitude" nuk kishte se si t'i shpëtonte vëmendjes së stafit të këngëtarit, aktorit dhe producentit emblematik amerikan Frank SINATRA (1915 - 1998) Mbi bazën e të njëjtës melodi, bashkëpunëtori i tij Paul Anka shkroi një tekst të ri të titulluar " I did it my way" (E bëra sipas mënyrës time) që, në fakt, është refreni dhe fundi i këngës në fjalë.

Pak a shumë kjo këngë shpreh "filozofinë" njerëzore të Sinatras; ai nuk ndjen asnjë keqardhje për jetën e jetuar, sepse gjërat i ka bërë në mënyrën e tij, me një jetë "plot"; kënga nuk ka kurrfarë reference me politikën. Ky superhit u vu për muaj të tërë në krye të gjitha çarteve muzikore në SHBA, Britaninë e Madhe dhe gjetikë; më vonë atë e kanë interpretuar artistë të tjerë të mëdhenj, duke përfshirë dhe Elvis Presley. Sukses i dhe jehona planetare e kësaj kënge legjendë vazhdon deri në ditët e sotme.

Dhe tani, le të shpjegojmë lidhjen/referencën e këtij hiti amerikan me titullin e këtij shkrimi, pra me politikën e më konkretisht me doktrinën e fundit të "Perandorisë" sovjetike.

Më 24 tetor 1989, lideri sovjetik Michael Gorbachov ndodhej për vizitë zyrtare në Helsink. Një ditë më vonë, mëngjesin e datës 25 tetor 1989, zëdhënësi i MPJ-së sovjetike, ambasadori Gennadi Gerasimov doli në një intervistë të



drejtëpërdrejtë për kanalin televiziv amerikan ABC " Good morning America". Moderatorit e pyeti Gerasimov lidhur për doktrinën e re sovjetike mbi të ardhmen e komunistizmit në vendet satelite të Evropës Qendrore dhe Lindore. Në përgjigjen e tij, zëdhënësi i mirënjohur i diplomacisë sovjetike iu referua pikërisht hitit të lartpërmendur, duke i thënë shprehimisht intervistuesit se "Ju kemi Sinatren që ka një këngë të titulluar " I did it my way".

Sipas tij, kjo këngë ishte thelbi i doktrinës së re politike sovjetike që linte të nënkuptohej qartë se secili vend lindor do të duhej të ecte në rrugën dhe mënyrën e vet. Në vijim ai iu përgjigj me një "PO" të madhe pyetjes nëse kjo doktrinë do të kishte efekte të menjëhershme. Kjo do të thoshte se BS nuk do të ndërhynte më me trupa ushtarake në ato vende. Madje, ai përmendi shembullin e Polonisë, ku disa javë më parë ishte bërë ndryshimi i qeverisë pa ndërhyrjen e trupave sovjetike.

Po ashtu, disa javë më parë ushtria sovjetike nuk kishte penguar kalimin e 600 shtetasve gjermano-lindorë në Sopron të Hungarisë dhe as të 6.000 të tjerëve nga Ambasada e RFGJ-së drejt perëndimit më 30 Shtator të atij viti.

të brendshme janë të mbyllura. Qartazi Hungaria nuk mban azilkerkues apo refugjatë që janë të një besimi tjetër fetar. Qëkur është krijuar si shtet në vitin 1000, Hungari lindi si një vend i centralizuar me besim katolik roman. Është disi delikate si çështje që të respektohet besimin fetar të një refugjati duke lënduar besimin fetar apo ndjeshmëritë religjioze të popullsisë së vendit tënd. Referendumi në Hungari në lidhje me këtë problematik rezultoi refuzues për pranimin e refugjatëve në këtë vend të Europës qendrore. Refugjatët hungarez të 1956-s nuk vlejné me sa duket si një shembull apo si një thirrje për reflektim ndryshe. Kujtesa nuk vlej kërka në këtë rast paralel diakronik në histori.

Kryeministri hungarez deklaroi se institucionet e BE-së kanë dështuar, se Komisioni Europian, Këshilli i Evropës dhe Parlamenti Europian nuk kishin mbrojtur dot Trak-

Kësisoj, "Sinatra", siç u njoh dhe publikisht, kishte zëvendësuar Doktrinën politiko-ushtarake "Brezhnjev". Kjo e fundit lejonte ish-BS që të ndërhynte ushtarakisht me forcat e saj të dislokuar në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore sa herë që mund të vihej në rrezik përmbyjsja e socializmit në këto vende.

Doktrina Sinatra ishte rrjedhojë e drejtëpërdrejtë e reformave madhore "Glasnost" dhe "Perestroika" të liderit të ri sovjetik Gorbachov mbi bazën e kushteve dhe rrethanave cilësish të reja politike, ekonomike dhe ushtarake në botë. Si pasojë e garës së shfrenuar të armatimeve, përfshirjes në të ashtuquajturën "Lufta e Yjeve" ku e futi me shumë mençuri udhëheqjen sovjetike Reagani me fillimin e viteve 80, Luftës 10 vjeçare në Afganistan, ekonomia sovjetike ishte rrënuar dhe për pasojë ishte bërë e praktikisht pamundur mbajtja e ushtrive të dislokuar në vendet e tjera lindore të Perandorisë së madhe sovjetike.

Vlen të përmendet se në vijim të takimit të mëparshëm me Presidentin amerikan Ronald Reagan në New York në dhjetor 1988 dhe në prag të takimit me Presidentin e ri amerikan G.H.W. Bush në Samitin historik të Maltës më 2 - 3 Dhjetor

1989, Gorbachovi u prit si hero dhe shpëtimtar nga masat e gjera të zhgënjyera nga regjimi i Honeker-it gjatë vizitës së tij në Berlinin Lindor në fillim të muajit Tetor, ku asistoi në festimet " mortore" me rastin e 40 vjetorit të krijimit të RDGJ-së. Shihej qartë se as Muri i Berlinit që po numëronte ditët e fundit dhe asnjë masë tjetër represive nuk mund të qetësonte më popullin e këtij vendi.

Veç presionit të papërbalueshëm ndërkombëtar e sidomos atij amerikan, Doktrina e re dhe e fundit sovjetike përputhej plotësisht me Ostpolitikën e famshme të lanuar nga ish-Kancelari legjendar gjerman Willy Brandt në fillim të viteve 70; të dyja, Ostpolitika dhe Doktrina Sinatra synonin ndryshimin e rregjimeve lindore jo me luftë, por nëpërmjet afrimit me popujt e tyre.

Kjo u pa qartë në RDGJ më 9 Nëntor kur u shemb Muri i Berlinit dhe me përmbynsjen e Çaushekut në Rumani më 25 Dhjetor; ku ushtria sovjetike ndenji indiferente. Në fakt, Gorbachovi i kishte paralajmëruar " të pabindurit" Honeker dhe Çausheku për një gjë të tillë.

Dihet tashmë se si u përmbynsja pa dhunë dhe armë regjimet e ndryshme lindore dhe kaluan në demokraci me sfidat dhe problemet e njohura. Në këtë drejtim ka dhe teori konspirative me emra dhe skenarë të ndryshëm, etj. Por, fakti publik është se të gjitha ato ndryshime kishin në themel Doktrinën "Sinatra"; një gjetje kjo do të thënë shumë e spikatur, duke zëvendësuar kësisoj "hard power" sovjetik me "soft power" amerikan.

Natyrishit zbatimi i kësaj doktrine ishte faktori i jashtëm më i rëndësishëm, sepse dihet që shembja e komunistizmit në këto vende ishte në radhë të parë rrjedhojë e krizës së paparë dhe të gjithanshme në këto vende në fundin e viteve 80.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, duke i dhënë doktrinës së fundit sovjetike emrin e megasartit të muzikës amerikane tingëlonte bindshëm por dhe bukur për veshët e politikanëve të lartë amerikanë dhe perëndimorë në përgjithësi.

parshme, partitë e krahut të majtë (MSZP DK, LMP, Párbezéd, Liberál, MOMA dhe Momentum) nuk do të mbajnë një demonstratë të përbashkët më 23 tetor ditën përkujtimore të 1956-s. Më parë, këto parti ishin bashkuar në thirrje për ndryshime në sistemin zgjedhor të Hungarisë. Megjithatë, demonstrata e përbashkët është anuluar; sipas organizatorit të ngjarjes Márton Gulyás, disa parti, duke përfshirë LMP, Momentum dhe Együtt, u tërhoqën nga ngjarja, duke lënë të kuptohet se demonstratën e planifikuar në thelb është pa kuptim.

Ja përse krizat e refugjatëve në kohë të ndryshme me gjithë tiparet identifikuese sjellin situata të pa takuara më parë sepse bota e sotme është më pak solidare, shumë me tepër konfliktuale dhe e rrezikuar si nga terrorizmi ashtu dhe ksenofobia...!

1956-shta hungareze gjithëherët të bën të reflektosh.

Horoskopi section with sub-headers: DASHI, DEMI, BINJAKET, GAFORJA, LUANI, VIRGJERESHA, PESHORJA, AKREPI, SHIGJETARI, BRICJAPI, UJORI, PESHQIT. Each section contains a small horoscope text.

Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikën e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së nëntëmbëdhjetë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikën që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Tra-

jtitimit të Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistër janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe prob-

lematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodrës, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve


kur subjekti kërkon të përfillojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të trualtit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur.

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E NËNTËMBËDHJETË)

(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Qazim	Kamata	Hilmi	Kamata	12 dy truall	Sterbeq, Koplik / 3515	73	10200	5200	ka vñj, ka harte
Smajl	Bishja	Skender ; Besnik	Bishja	400 m2 truall	Koplik / 2220	76	400		Ka vñj, ka planvend osje
Beqir	Lacaj	Beqir	Lacaj	2230 m2 truall	Bajze Kastrat / 3982	88	2230	1730	Ka vñj, ka planvend osje
Salih	Lezha	Syri	Lezha	dyqam me siperfaqe 146 m2 truall	Zagore Shkrel / 3870	89	146		Ka vñj, ka planvend osje
Kadri	Kurtaj	Kadri	Kurtaj	12295 m2 truall	Koplik / 2220	90	12295	230	Ka vñj, ka planvend osje
Asllan	Bekteshi	Cezar	Bekteshi	1000 m2 truall	Gril / 1864	91	1000	1000	Ka vñj, ka planvend osje
Nike	Gjeloshi	Petrit	Dodaj	9 dy truall	Pjetroshe n Kastrat / 2977	92	9000		Ka vñj, ka planvend osje
Feride	Rukaj	Feride	Rukaj	8.5 dy truall	Gruemire / 1871	94	2418	1018	Ka vñj, ka planvend osje
Mitro	Malaj	Gjuro	Malaj	138.08 dy toke bujqesore +truall	Boric I vogel Gruemire / 1245	95	138 000	1082	Ka vñj, ka planvend osje
Mihat	Shuto	Marku	Shuto	47525 m2 truall	Boric I vogel Gruemire / 1245	96	60400	5000	Ka vñj, ka planvend osje
Muhamet ; Xhevdet	Myftia	Xhevdet	Myftia	shtepi pa siperfaqe + 9 dy truall	Boric Gruemire / 1244	74	9000	2940	ka note transkript i ka vñj ka harte
Fatime	Dizdari	Shpetim	Dizdari	1500 m2 truall	Omaraj Vrake / 2827	75	1500	1500	ka vertetim pronesie ka harte
Cen	Banushi	Ramiz	Banushi	7.6 dy truall+ 13640 m2 truall	Kaldrun Koplik / 2047	77	18640	872	ka vñj ka harte
Nikoll	Leka	Ndoc	Çoba	shtepi pa siperfaqe	shkoder	247	Mbyllje procedimi		ka vertetim pronesie ka harte
									Ka dhe nje vendim tjetër te ZRKKP nr. 172, dt. 31.12.2007 me te cilin i eshte njohur dhe komp. Sip. 9700 m² toke bujq. ne fshatin Dragocka vertetim hipotekor ka harte
									ka vendim te meparshem komisioni
									ka note transkript i ka vertetim hipotekor
									ka vertetim pronesie ka note transkript i.Vendimi ka marre forme te prerë me urdh. Nr.1449/3, dt.22.2.2010
									ka flete regjistri
									ka vertetim ipotekor
Gjon	Serreqi	Guljem	Serreqi	6000 m2 toke bujqesore		1526	172/1	6000	6000
Trashg. Bekteshi, Kazazi, Berdica, Sykja		Vehbi	Hamzi	plotesim vendim komisioni 75 m2 truall		8592		440	Plotesim akti administrativ
Gjon e vellezer Serreqi		Guljem	Serreqi	58200 m2 toke bujqesore		1159-2565		207	52000
Trashegi mtaret e Abdyl Lohja		Petrit	Hoxhiqi	4730 m2 toke bujqesore		2750		480	4730
Malo	Çelepija (Osja)	Xhemal	Çelepija	27795 m2 toke bujqesore		2566	181/1	25780	2273
Gjon e vellezer Serreqi	Serreqi	Guljem	Serreqi	8820 m2 toke bujqesore		1157		167	8820

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashtë.
- Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhen për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trouareat.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë .
- Preka komik shkordran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë
- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.
- Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.

VERTIKAL

- Si i përshatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Eshhtë metri i rrobaqepësit.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë .
- Ishin monedhe të Tobias.
- Eshhtë bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Eshhtë marrëveshje me nota.
- Ishite babai i Akilit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Eshhtë faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Eshhtë shtet aziatik.
- Eduard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Unë i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samurai.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktores.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Eshhtë ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.
- Ente Ekonomike Sarandë.
- Mbyllin një ditat.


VERTIKAL

- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Eshhtë kolana në filma
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktores.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Eshhtë ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.
- Ente Ekonomike Sarandë.
- Mbyllin një ditat.




- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Glysma e lufjes.
- Castelliito aktor.
- Inciliat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Eshhtë trysni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktores.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë take në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inciliet e Nolte-s.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		4	6	5	8	2		
	8		1					6
	3	2	9			8	1	
5					1		8	
	9	7				5	4	
	6		4					3
	2	6			3	9	7	
4					9		5	
		9	8	7	4	1		

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	8	7	4	5	1	9	3	2
4	3	9	8	2	6	7	1	5
5	2	1	9	3	7	4	6	8
2	4	6	1	8	3	5	7	9
7	9	5	6	4	2	1	8	3
3	1	8	7	9	5	2	4	6
8	7	2	5	6	4	3	9	1
1	6	3	2	7	9	8	5	4
9	5	4	3	1	8	6	2	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

"Një mik i vërtetë është shumë e vështirë që të gjendet, shumë e vështirë që të largohet, është e pamundur që të harrojë".

"Disa herë, akoma dhe gjërat më të parëndësishme do të mund të ishin gjëra të jashtëzakonshme, nëse do t'i bënim me njerëzit e duhur".



Elizabeth Green

"Të mund të flesh i qetë, të mund të duash dhe të mbash mend se këtu jemi të gjithë kallimtarë".

Jorge Luis Borges

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	L	E	X	S	G	P	O	A	Z	I	
M	I	S	H	N	D	O	R	E	S	H	R
A	R	A	M	O	G	O	A	U	T	O	
M	K	I	M	N	O	V	A	K	O	N	
T	S	E	R	I	A	L	I	A	R	T	I
P	R	E	T	E	N	D	I	M	I	O	K
R	O	N	A	L	E	D	O	I	G	A	E
M	A	L	E	N	G	O	R	E	T	E	
B	A	T	A	R	I	A	T	E	R	O	R
I	R	O	N	A	C	E	M	Y			
L	T	R	I	K	E	F	A	R	O	D	I
L	O	I	R	A	C	O	R	O	T	K	N

FJALËKRYQI (1)

F	A	L	L	I	K	E	S	D	O	R	
A	D	A	M	P	A	L	L	I	M	I	N
L	E	M	T	A	B	E	L	L	A	T	T
A	T	K	A	P	I	T	U	L	L	I	M
N	M	A	R	I	N	A	R	I	F	I	L
G	R	E	M	I	N	A	U	E	F	E	
A	R	I	F	D	E	N	T	I	S	T	
P	I	K	A	T	E	S	E	R	T	E	
C	I	T	A	T	E	M	E	T	O	R	E
O	S	Z	R	A	M	E	T	R	T		
S	H	I	E	P	I	T	E	L	E	J	A
A	E	K	A	M	I	V	I	S	A	R	I

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mërcura

- Mënyra e vetme për të jetuar, është të pranosh çdo minutë të kësaj jete si një mrekulli të papërsëritshme. (M. Storm Xhejmsjon)
- Mediokriteti nuk njihet asgjë më të lartë se veten e vet. (A. Konan Dojl)
- Jeta është përsosje pa fund. Të quash veten të përsosur, do të thotë...të vrasësh veten. JOHANN P. HEBEL Shkrimtar (1760-1826)
- Për të njohur vetveten, duhet ditur gjithçka për të tjerët. (Oskar Uajlld)

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

